



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

R R E G U L L O R E

Nr. 32, datë 26.12.2013

**Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive
dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit
me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri**

Përmbajtja

1. Hyrje	4
1. Historiku	1
2. Informacion mbi Legjislacionin dhe Politikën e sektorit	2
2.1 Informacion i përgjithshëm.....	2
2.2 Rregullimi i sipërmarrësve me FNT	2
2.3 Historiku i politikës rregullatore të BE	3
2.4 Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit	3
3. Parimet e Përgjithshme të Kontabilitetit Rregullator	5
3.1 Hyrje e përgjithshme.....	5
3.2 Parimet e kontabilitetit rregullator	5
3.3 Parimet e alokimit të kostove	6
3.4 Dokumentacioni i kontabilitetit rregullator	6
3.4.1 Metodologjitë	6
3.4.2 Politikat e kontabilitetit	7
3.4.3 Cilësia e të dhënave	7
3.5 Auditimi	8
3.6 Publikimi.....	9
3.7 Udhëzim përmbledhës.....	10
4. Parimet e Ndarjes së Llogarive	12
4.1 Metodologjia e alokimit	12
4.1.1 Procesi i alokimit të kostove.....	12
4.1.2 "Kaskada" ose hierarkia e alokimit të kostove.....	12
4.1.3 Shërbimet me FNT dhe pa FNT.....	13
4.2 Llogaritja e kostove.....	14
4.2.1 Kontabiliteti i Kostos Historike dhe Kontabiliteti i Kostos Aktuale	14
4.2.2 Ruajtja e kapitalit	15
4.2.3 Kostoja e kapitalit dhe kapitali i punësuar	17
4.3 Kostoja Shtëse Afat-Gjatë	18
4.3.1 Inkrementi.....	19
4.3.2 Modelimi i kostove LRIC	19
4.3.3 Matja e kostove	19
4.3.4 LRIC-ja e "Pastër".....	20
4.3.5 Zbatimi i LRIC-së në praktikë.....	20
4.4 Pagesat e transferimeve.....	22
4.5 Rakordimi	22
4.6 Auditimi	23
5. Integriteti dhe Mirëmbajtja e të Dhënave	24
6. Publikimi dhe Pajtuueshmëria	25
6.1 Transparenca	25
6.2 Konfidencialiteti	25
6.3 Publikimi.....	26
6.4 Tregjet përkatëse.....	26
7. Afatet kohore	28
7.1 Këshillimi dhe implementimi	28
7.2 Tranzicioni	28
7.3 Procesi periodik.....	29
Shtojca 1 – Udhëzimet për Llogaritjen e Kostove	30
A1 Alokimi dhe atribimi i kostove	30
A1.1 Procesi i alokimit të kostove.....	30

A1.2 Shkaktimi i kostos.....	32
A1.3 Kostot operacionale.....	32
A1.4 Kostot e kapitalit dhe kapitali i punësuar.....	34
A1.5 Pagesat per transferimet.....	37
A1.6 Të ardhurat.....	37
A2 Vlerësimi i aktiveve.....	40
A2.1 Llogaritja e kostos aktuale.....	40
A2.2 Ruajtja e kapitalit.....	40
A2.3 Udhëzime të tjera për vlerësimin e aktiveve.....	41
A3 Modelimi LRIC.....	42
A3.1 Karakteristikat e modelit LRIC.....	42
A3.2 Kategoritë dhe analiza e kostos.....	43
A4 Udhëzime të tjera për ndarjen e llogarive.....	44
A4.1 Ndarja e llogarive dhe koha e ditës.....	44
A4.2 Modelet e kostos.....	44
A4.3 Dokumentacioni i modelit të kostos.....	45
A4.4 Auditimi i modelit të kostos.....	45
Shtojca 2 Raporte shembuj.....	46
A2 Pasqyrat Kryesore Financiare.....	47
A2.1.1 Fitimi dhe humbja (pamja e tregut) – Telefonia Fikse.....	47
A2.1.2 Fitimi dhe humbja (pamja e tregut) – Telefonia Celulare.....	48
A2.2.1 Të ardhurat dhe shpenzimet (Pamja e brendshme/jashtme) – Telefonia Fikse.....	50
A2.2.2 Fitimi dhe humbja (Pamja e brendshme/jashtme) – Telefonia Celulare.....	52
A2.3 Kapitali mesatar në përdorim (i punësuar).....	53
A2.4 Pasqyra e Transferimeve.....	54
A2.5 Përmbledhje për Transferimet brenda Biznesit.....	55
A2.6 Pasqyra e Rakordimit - Fitimi dhe Humbjet (të ardhurat dhe shpenzimet).....	56
A2.7 Kapitali i Mesatar i Konsoliduar.....	57
2.5 A2.8 Pasqyra e kostove të shërbimeve të rrjetit.....	58
A2.9 Përmbledhje e kostove të rrjetit.....	60
A3 Informacion Shtesë.....	64
A3.1 Deklarata Shpjeguese.....	64
A3.2 Informacion Financiar Shtesë.....	64
A4 Opinioni i Auditimit.....	66
Shtojca 3 Fjalor i Termave.....	67

1. Hyrje

Ky dokument paraqet versionin final të Rregullave për Kontabilitetin Rregullator dhe udhëzimet shoqëruese të tyre. Ky dokument ka qenë objekt i procesit të konsultimit publik, i cili u krye më 30 Tetor-30 Nëntor 2013.

Komentet e marra nga palët e interesuara gjatë kësaj periudhe konsultimi u shqyrtuan me kujdes dhe janë marrë në konsideratë në përgatitjen e këtij versioni final të dokumentit.

1. Historiku

Objektivat kryesore të kuadrit rregullator për tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri janë nxitja e konkurrencës dhe rritja e mirëqenies së konsumatorëve dhe parandalimi i abuzimit me dominancën nga pjesëmarrësit në treg, duke përfshirë veprime të tilla si çmimet grabitqare dhe subvencionet e kryqëzuara (të tërthorta) të shërbimeve nën rregullim dhe të parregulluara brenda organizatave të integruara vertikalisht.

Sipërmarrësit që janë përcaktuar si Sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në tregje të caktuara, kanë detyrim të përgatisin, dorëzojnë në AKEP dhe të publikojnë dokumenta mbi kontabilitetin rregullator në përputhje me masat rregullatore. Kjo është pjesë e një grupi detyrimesh ekzistuese të raportimit dhe detyrimit të orientimit në kosto të tarifave të terminimit fiks dhe celular.

Këto rregulla të kontabilitetit rregullator dhe udhëzimet përkatëse të sistemit të kontabilitetit po publikohen nga AKEP për të ndihmuar Sipërmarrësit me FNT të zhvillojnë sisteme kontabiliteti rregullatore dhe përmbushin detyrimet e tyre rregullatore.

Sikurse është bërë e qartë në tekstin e këtij dokumenti, këto parime dhe udhëzime të përgjithshme të kontabilitetit rregullator janë gjenerike dhe janë të aplikueshme për të gjithë Sipërmarrësit me FNT. Udhëzimet specifike dhe detajet e formatit të raportimit janë paraqitur në dokument dhe në Shtojcat e tij, duke dhënë kërkesat për pjesë specifike të tregut Shqiptar të telekomunikacioneve dhe Sipërmarrësve që ndikohen nga këto rregulla.

Ky dokument përfshin një përshkrim të historikut të përvojës dhe politikave përkatëse ndërkombëtare dhe detaje të bazës ligjore dhe rregullatore Shqiptare për këto masa dhe kërkesa rregullatore.

Ky dokument përfshin edhe detaje e udhëzime për kërkesat e auditimit të kontabilitetit rregullator për Sipërmarrësit me FNT, detaje të publikimit dhe pajtueshmërisë dhe një përshkrim të afateve kohore për tranzicionin dhe krijimin e një procesi periodik në të ardhmen.

Edhe pse qëllimi kryesor i rregullave të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostos është që të mbështesë rregullimin ekonomik të Sipërmarrësve me FNT, që i shërbejnë një tregu konkurrues në Shqipëri, detyrimet janë të balancuara me proporcionalitetin dhe praktikabilitetin dhe do të jenë të dobishme për të gjithë aktorët kryesorë dhe pjesëmarrësit në tregjet e ndikuara.

Këto rregulla dhe udhëzime pritet që të ndryshojnë me kalimin e kohës, pasi ato mund të rishikohen dhe përditësohen për të pasqyruar ndryshimet në tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri dhe si të tilla mund t'i nënshtrohen rishikimit dhe këshillimit në të ardhmen.

2. Informacion mbi Legjislacionin dhe Politikën e sektorit

2.1 Informacion i përgjithshëm

AKEP është autoriteti rregullator i komunikimeve elektronike të Shqipërisë, që vepron në zbatim të ligjit Nr. 9918 (Maj 2008) “*Mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, i cili mbikëqyr industrinë e komunikimeve elektronike në Shqipëri. AKEP-i është një person juridik publik, i cili funksionon i pavarur nga qeveria.

Ligji 9918 rregullon tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke synuar të nxisë konkurrencën efektive dhe zhvillimin e infrastrukturës, së bashku me ofrimin eficient të shërbimeve në Shqipëri. Ligji është hartuar për të transpozuar parimet e paketës rregullatore të Direktivave të BE-së të vitit 2002 në ligjin Shqiptar. Parlamenti Shqiptar ka miratuar ndryshimet e propozuara të ligjit 12/2012, që ndryshon ligjin 9918, për ta përshtatur me Direktivat e rishikuara të BE-së të vitit 2009.

AKEP-i ka publikuar disa rregullore për sektorin e komunikimeve elektronike, përfshirë rregullore mbi aksesin dhe interkoneksionin, analizën e tregut, sistemin e autorizimit të përgjithshëm dhe raportimin e të dhënave statistikore dhe financiare. Ndryshimet e Rregullores Nr. 9, datë 17 Korrik 2009 mbi analizën e tregut u miratuan më 31 korrik 2013. Nëpërmjet ndryshimeve të kësaj rregulloreje, lista e tregjeve përkatëse të Shqipërisë tani është e njëjtë me atë të Rekomandimit të BE-së të vitit 2007 për tregjet përkatëse.

2.2 Rregullimi i sipërmarrësve me FNT

Në Korrik 2012, AKEP përcaktoi se katër Sipërmarrësit celularë kanë FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre (vendimet 2119-2122) dhe vendosi masat rregullatore përkatëse, të cilat përfshinë mos-diskriminimin, publikimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit (RIO), masat rregulluese për interkoneksionin dhe kontrollin e tarifave, së bashku me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos. Vendimi 1505 (Shkurt 2011) vendosi masën e kontrollit të tarifave të terminimit të thirrjeve zanore në tregun celular bazuar në kostot sipas modelit LRIC. Vendimet 1506-1508 përcaktuan metodologjinë e rregullimit të tarifave për orientimin në kosto të tyre, dhe Vendimet 2119-2122 konfirmuan reduktimin e përshkallëzuar me disa ndryshime për Sipërmarrësin Plus Communications.

Vendimet rregullatore 1710-1713 (Tetor 2011) përcaktuan katër Sipërmarrësit celularë si sipërmarrës me FNT për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre dhe vendosën detyrime mbi Sipërmarrësit, përfshirë detyrimet për mos-diskriminimin, transparencë dhe kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto të tyre.

Me Vendimin 1348 (Korrik 2010), AKEP-i përcaktoi Altelecom-in si Sipërmarrës me FNT në disa tregje përkatëse, duke përfshirë shërbimet me pakicë dhe shërbimet me shumicë të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjete fikse. Masat rregullatore të vendosura përfshinin mos-diskriminimin, dhënie aksesit, publikimin e një RIO dhe ofertën e aksesit, si dhe masat rregullatore për kontrollin e tarifave, së bashku me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos. Në 2012-n, AKEP nxorri në konsultim publik një analizë të re të tregut fiks (Vendimi 2138), dhe në të ardhmen e afërt pritej që të kishte një vendim rregullator në lidhje me këtë analizë. Detyrimet rregullatore mbi Altelecom në lidhje me FNT sipas analziës së re u propozuan që të mos ndryshonin, përveç propozimit të heqjes së rregullimit të tarifave me pakicë. Më 30 Korrik AKEP publikoi Vendimet Nr 2336 dhe Nr. 2337, duke e përcaktuar

Albtelecom si Sipërmarrës me FNT mbi disa tregje me shumicë dhe pakicë, duke ri-vendosur ndaj Albtelecom detyrimet e ndarjes së llogarive.

Me vendimin 1565 (Prill 2011), AKEP përcaktoi Albtelecom-in si Sipërmarrës me FNT në tregjet me shumicë për aksesin në infrastrukturë fizike (LLU) dhe aksesit me shumicë broadband. Masat rregullatore janë si ato të përshkruara më sipër dhe përfshijnë detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostos. E njëjta gjë është vendosur për tregjet me pakicë e shumicë të linjave me qira nëpërmjet Vendimit 1564 (Prill 2011), së bashku me detyrimet e kontrollit të tarifave dhe orientimit në kosto për linjat me qira dhe LLU-të që dalin nga modeli LRIC, i përmendur më sipër në lidhje me terminimin e thirrjeve.

Për sa më sipër, detyrimet rregullatore të ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos zbatohen mbi katër Sipërmarrësit celularë për terminimin e thirrjeve dhe Albtelecom-in për interkoneksionin, LLU-në dhe tregjet e dhënies së linjave me qira.

Rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara në këto dokumente plotësojnë detyrimet që përmban ligji 9918, dhe çdo përditësim e ndryshim përkatës, në lidhje me detyrimet e kontrollit të tarifave, transparencën, metodologjitë dhe kërkesat përkatëse për orientimin në kosto. Sipërmarrësit e shpallur me FNT do të kenë të gjithë informacionin dhe udhëzimet e kërkuara për të plotësuar detyrimet e ndarjes së llogarive, pagesat e transferimit dhe llogaritjen e kostos, vendosur mbi ta nga vendimet rregullatore të mara nga AKEP-i në përputhje me ligjin shqiptar.

2.3 Historiku i politikës rregullatore të BE

AKEP-i ka zbatuar një kuadër rregullator mbështetur në transpozimin e Direktivës së BE-së të vitit 2002 (2002/21/EC), ndryshuar më 2009 (2009/140/EC). Rregullat e telekomunikacionit Shqiptar, po ashtu reflektojnë bazat rregullatore përkatëse të BE-së për aksesin dhe interkoneksionin (2002/19/EC) dhe autorizimin (2002/20/EC). Rekomandimi i BE-së 98/322/EC përmbante dispozita për rregullimin e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos për Sipërmarrësit me FNT. Ai u përditësua dhe ndryshoi nga rekomandimi 2005/698/EC për të reflektuar ndryshimet e objektit dhe kushteve në tregjet përkatëse në vijim të Direktivës 2002. Masat rregulluese janë përfshirë në Nenin 11 të Direktivës së Aksesit (2002/19/EC) dhe Nenin 13 të Direktivës Kuadër (2002/21/EC).

Në 2005, Grupi Evropian i Rregullatorëve (ERG) publikoi udhëzimet për zbatimin e rekomandimeve mbi sistemet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos (ERG (05) 29). Qëllimi i dokumentit ishte që të udhëzonte sipërmarrjet e rregulluara sesi të zbatonin sisteme të përshtatshme për të qenë në përputhje me detyrimet dhe standardet e caktuara për procesin dhe procedurën në autoritetet rregullatore ndërkohë që përcaktojnë pajtueshmëri. BEREC (pasuesi i ERG-së) tani kryen rishikime periodike të zbatimit të ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos në gjithë BE-në, që përshkruajnë masën dhe natyrën e masave rregullatore të zbatuara së bashku me detaje të tjera rregullatore përkatëse.

Në 2009-n Komisioni Evropian publikoi një rekomandim për terminimin e tarifave të telefonisë fikse dhe celulare në gjithë BE-në (2009/396/EC), me qëllimin specifik që të rriste konvergjencën dhe konkurrimin, duke arritur tarifa më të ulëta dhe duke harmonizuar trajtimet rregullatore. Ky dokument rekomandoi që tarifat simetrike të caktoheshin bazuar në modelin nga poshtë-lartë (BU) LRIC, duke përdorur kostot aktuale dhe mbështetur në modelin e një Sipërmarrësi eficient. Që në 2009-n, këto rekomandime janë zbatuar gjerësisht në gjithë BE-në.

2.4 Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit

Në përgjithësi, raportimi rregullator financiar duhet të ndjekë parimet e përcaktuara nga standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, të cilat duhet të jenë në përputhje me

praktikat që tashmë ndiqen brenda entiteteve të rregulluara. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) prodhon standarde të njohura si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të cilat janë miratuar dhe zbatohen brenda BE-së. Organizime të tilla janë të përshtatshme edhe për tregun në Shqipëri.

3. Parimet e Përgjithshme të Kontabilitetit Rregullator

3.1 Hyrje e përgjithshme

Sipërmarrësit e telekomunikacioneve që kanë detyrim të paraqesin llogari rregullatore duhet të zhvillojnë sisteme kontabiliteti që të mund t'i përgatisin ato. Llogaritë rregullatore realisht do të përfshijnë një numër dokumentesh dhe tabelash, përfshi pasqyra financiare rregullatore, përshkrime të metodologjisë, politika të përgjithshme të kontabilitetit dhe politika të transferimeve. Shpjegimet gjithëpërfshirëse dhe të qarta të metodologjive dhe presupozimeve, së bashku me justifikime të plota, janë një pjesë thelbësore e dokumenteve të dorëzuara të kontabilitetit rregullator.

Dokumentet mbështetës rrisin së tepërmi transparencën dhe dobishmërinë e përgjithshme të llogarive rregullatore të gjithë aktorëve kryesorë, përfshi vetë entitetin e rregulluar. Për këtë arsye pasqyrat financiare dhe tabelat dhe dokumentacionet mbështetëse duhen parë si një objekt i tërë i integruar plotësisht.

Pjesët më poshtë përcaktojnë parimet e kontabilitetit rregullatore që duhen ndjekur nga çdo Sipërmarrës FNT në Shqipëri, e mbulojnë metodologjitë financiare, dokumentet mbështetëse, mirëmbajtjen e të dhënave dhe auditin.

3.2 Parimet e kontabilitetit rregullator

Këto parime duhen aplikuar nga Sipërmarrësit me FNT për zbatimin e detyrimeve të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostos. Ato aplikohen në procesin e përgatitjes, auditimit dhe publikimit të pasqyrave e tabelave të kontabilitetit rregullator dhe mbajtjes së të dhënave financiare.

Parimet janë si më poshtë:

- a) Prioriteti dhe proporcionaliteti
Nëse ka ndonjë konflikt ndërmjet kërkesave të njërit ose të gjitha këtyre parimeve, ato do të zbatohen në të njëjtin rend prioriteti në të cilin janë paraqitur në këtë dokument. Në të njëjtën kohë, duhet krijuar një ekuilibër proporcional dhe i duhur ndërmjet parimeve. AKEP-i mund të ofrojë udhëzime mbi zbatimin e parimeve mbështetur në raste individuale.
- b) Shkaktimi i kostove
Të ardhurat (përfshi transferimet), kostot (përfshi transferimet), aktivet dhe detyrimet u duhen caktuar elementëve të rrjetit, produkteve dhe shërbimeve me shumicë dhe me pakicë në përputhje me aktivitetet që shkaktjnë (gjenerojnë) të ardhurat të fitohen, kostot të pësohen, aktivet të blihen ose borxhet të krijohen.
- c) Transparenca
Metoda e alokimit dhe atribuimit që përdoret duhet të jetë transparente. Kostot dhe të ardhurat që alokohen direkt te bizneset ose aktivitetet duhen dalluar veçmas nga ato që ndahen midis tyre.

- d) Objektiviteti dhe mos-diskriminimi
Alokimi ose atribuimi i të ardhurave dhe kostove duhet të jetë objektiv dhe nuk duhet synuar që të përfitojë subjekti i rregulluar ose ndonjë produkt, shërbim, element rrjeti ose biznes i veçantë (i ndarë).
- e) Konsistenca e zbatimit
Parimet e kontabilitetit rregullator duhet të zbatohen në mënyrë konsistente nga viti në vit. Atje ku ka ndryshime në parimet e kontabilitetit rregullator, metodat e alokimit dhe atribuimit, transferimet ose politikat e përgjithshme të kontabilitetit që kanë një ndikim material mbi informacionin e raportuar në pasqyrat financiare rregullatore apo pjesë të pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm të ndikuara nga ndryshimet, do të paraqiten sërish. Në këtë aspekt ndryshime materiale konsiderohen ato që kanë një efekt +/-10%.
- f) Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Përveçse kur është deklaruar shprehimisht ndryshe, do të zbatohen Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

3.3 Parimet e alokimit të kostove

Parimi i shkaktimit të kostove është i ndërlikuar dhe i rëndësishëm për zhvillimin e metodologjive dhe sistemeve të alokimit të kostove. Hollësitë mbi metodologjitë e kostos janë dhënë në seksionin e mëposhtëm mbi ndarjen e llogarive dhe Shtojca 1 ofron udhëzime specifike për llogaritjen e kostos.

Ky dokument synon të përshkruajë dhe të përcaktojë metodologjitë përkatëse për llogaritjen e kostos dhe politikat shoqëruese të kontabilitetit si dhe të ofrojnë udhëzime të qarta mbi kërkesat për kontabilitetin rregullator. Në veçanti, ky dokument mbulon çështje që kanë të bëjnë me Kontabilitetin e Kostos Aktuale (CCA) dhe llogaritjen e Kostove Afat-Gjatë Inkrementale (LRIC).

3.4 Dokumentacioni i kontabilitetit rregullator

Sipërmarrësi me FNT në Shqipëri kanë detyrim, sikurse është përcaktuar nga AKEP-i dhe specifikuar nga ligji, të përgatisin pasqyra financiare rregullatore dhe dokumentacionin shoqërues. Pasqyrat dhe dokumentet e përgatitura duhen të auditohen dhe publikohen në përputhje me afatet kohor të përcaktuara, të cilat trajtohen në Seksion 7 të këtij dokumenti. Seksioni 3.6 përmban detaje të dokumentave që duhet të publikohen.

3.4.1 Metodologjitë

Është e rëndësishme që metodologjitë e përdorura nga Sipërmarrësit me FNT me detyrime të kontabilitetit rregullator të dokumentohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, për të siguruar që pajtueshmërinë me parimin e transparencës dhe për të optimizuar dobishmërinë e pasqyrave të botuara.

Dokumentacioni duhet të përfshijë një përshkrim të plotë të metodologjisë së përdorur për të alokuar dhe atribuuar të ardhurat, kostot, aktivet, detyrimet dhe kapitalin e punësuar (përdorur). Ky përshkrim duhet përgatitur në pajtim me parimet, rregullat dhe udhëzimet e paraqitura në këtë dokument dhe Shtojcat shoqëruese. Brenda përshkrimit duhet të jenë hollësitë e plota për bazat (mënyrat) e përdorura për përcaktimin e transferimeve ndërmjet njësive ose seksioneve të diz-agreguara (të veçanta). Kjo do të përfshijë metodologjitë e kërkuara për të siguruar që

bizneset e rregulluara të tarifojnë veten mbi baza të barabarta me tarifën për Sipërmarrësit e tjerë kur ju kërkohet që ta bëjnë këtë gjë. Të dhëna të mëtejshme mbi transferimet janë dhënë në Seksionin 4 të këtij dokumenti dhe Shtojca 2 përmban një format (template) për raportimin e transaksioneve të transferimeve.

Dokumentacioni duhet të përfshijë edhe një përshkrim të metodologjive të përdorura për të përgatitur kostot, që përfshin referencën me bazat (llojet) dhe standardet e kostos, koston e elementit të rrjetit, metodologjinë përkatëse të alokimit si dhe identifikimin dhe trajtimin e kostove të ndara dhe të përbashkëta.

3.4.2 Politikat e kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit të përfshira brenda dokumentacionit duhet të ndjekin formatin e përdorur për përgatitjen e llogarive standarde ligjore dhe do të përfshijnë hollësi të trajtimit të llojeve specifike të kostove, politikave të zhvlerësimit dhe bazat për vlerësimin e aktiveve. Transparenca e politikës së kontabilitetit është thelbësore për të kuptuar dhe interpretuar llogaritë rregullatore dhe auditimin e tyre.

3.4.3 Cilësia e të dhënave

Të dhënat brenda dokumentacionit duhet të jenë të rëndësishme, të krahasueshme me periudha të mëparshme raportimi dhe të jenë të besueshme. Duhet të sigurohet edhe integriteti i të dhënave përgjatë periudhave kohore duke mbajtur një gjurmë të përshtatshme auditimi për të gjithë informacionin përkatës (relevant).

a) Rëndësia

Informacioni i rëndësishëm do të ketë mundësinë të ndikojë dhe informojë vendim-marrjen e përdoruesve të dokumentacionit dhe do të ofrohet brenda një afati kohor që lejon të ndihet ndikimi i tij. Ky informacion mund të përdoret për të vlerësuar dhe çmuar ngjarjet e tanishme dhe të ardhme si dhe për të konfirmuar gjykimet e bëra kur trajtohet e kaluara. Në mënyrë që të jenë të rëndësishme, llogaritë rregullatore duhet të përgatiten në përputhje me afatet kohore të specifikuar dhe parimet e përcaktuara në Seksionin 3.2 më sipër.

b) Krahasueshmëria

Dobia e informacionit financiar rregullator rritet së tepërmi nga aftësia për t'a krahasuar atë me çfarë është raportuar në periudhat e mëparshme, në mënyrë që të kryhet interpretimi i tendencave dhe ndryshimeve. Ky aspekt është shumë i rëndësishëm për AKEP-in pasi e mundëson të vlerësojë efektshmërinë e politikës rregullatore, ndikimin e konkurrencës dhe të analizojë të dhënat financiare për të marrë vendime të informuara në të ardhmen.

Ndjekja e parimeve të përcaktuara duhet ta mundësojë një sipërmarrës raportues që të sigurojë krahasueshmëri. Konsistenca dhe një përshkrim i plotë i politikave të kontabilitetit janë veçanërisht të rëndësishme për këtë gjë. Sikurse është përcaktuar në Seksionin 3.2, ndryshimet e politikave që rezultojnë në ndikime materiale duhet të çojnë te ri-deklarimi i të dhënave financiare të periudhës së mëparshme për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme.

c) Besueshmëria

AKEP, Sipërmarrësit me FNT dhe gjithë aktorët e tjerë kryesorë duhet të jenë në gjendje të mbështeten në informacionin e përfshirë brenda llogarive rregullatore. Për të vlerësuar besueshmërinë e të dhënave financiare normalisht zbatohen kritere, që përfshijnë teste për besueshmërinë, pavarësinë nga anësitë sistematike ose të qëllimshme, pavarësinë nga gabimet materiale, tërësinë dhe kujdesin.

Përgjegjësinë për siguruar besueshmëri e llogarive rregullatore e ka Sipërmarrësi me FNT. Ky aspekt i raportimit dhe i publikimit do të përfshijë auditues dhe qeverisje (menaxhim) mbi miratimin e raporteve përfundimtare dhe pasqyrave financiare.

d) Ruajtja e të dhënave

AKEP mund të kërkojë që të jepet informacion financiar përgjatë disa periudhave kohore të ndryshme për të kryer funksionet e tij normale rregullatore. Prandaj, të gjitha informacionet financiare, do të ruhen nga Sipërmarrësit me FNT për të paktën pesë vjet të plotë financiarë, në mënyrë që të dallohen kostot, të ardhurat, aktivitetet dhe efektet e ndryshme të metodologjisë në një hark kohor. Kjo natyrisht që ka lidhje me kontrollin e llogarive rregullatore dhe duhet të konsiderohet së bashku me Seskionin 5 të këtij dokumenti.

3.5 Auditimi

Llogaritë rregullatore të prodhuara nga Sipërmarrësit me FNT në Shqipëri duhet që t'i nënshtrohen auditimit të pavarur në përputhje me ligjin përkatës dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Auditimi do të pritet të dokumentojë dhe justifikojë çdo teknikë kampionimi të përdorur. Opinioni i auditit duhet të deklarojë se llogaritë rregullatore janë paraqitur në mënyrë të drejtë.

Kërkesat e integritetit për të dhënat e përdorura në llogaritë rregullatore duhen zbatuar duke treguar se të dhënat e përdorura janë të njëjta sikurse dhe ato që janë paraqitur fillimisht në sistemet e informacionit pasi i janë nënshtuar auditimit ligjor të kontabilitetit. Gjurma audituese elektronike ose me letra duhet të jetë e disponueshme për të kryer të gjitha testet dhe verifikimet.

Elementët kryesorë që duhen mbuluar gjatë auditimit janë si më poshtë:

- Objektin e kostove të përfshira në model dhe të alokuara në produktet e rregulluara.
- Përshtatshmërinë e metodologjive të përdorura për alokimin e kostove, vlerësimin e aktiveve, zhvlerësimin dhe transferimet.
- Saktësinë e të dhënave për sasi, nivelet e veprimtarisë dhe matjet teknike.
- Rakordimin e modelit të kostos dhe kontabilitetit rregullator me llogaritë ligjore financiare.

Ngritja e sistemeve dhe krijimi i aktiviteteve e proceseve të auditit për herë të parë mund të kërkojë punë dhe kohë shtesë, por sasia e punës së nevojitur do të pakësohet çdo vit ndërkohë që përcaktohet praktika më e mirë dhe standardizohen proceset.

Duke qenë se AKEP-i është përfituesi kryesor i informacionit të kontabilitetit rregullator dhe burimi i vendosjes së detyrimeve, AKEP-i duhet të marrë pjesë në procesin e caktimit të

auditëve të kualifikuar siç duhet nga subjektet e rregulluara. Kjo do të përfshijë ndjekjen e një procesi të përcaktuar në pikat e mëposhtme. Ky proces do t'i nënshtrohet rishikimit dhe përmirësimit nëpërmjet bashkëpunimit dhe rënies dakort bashkarisht midis AKEP dhe Sipërmarrësve me FNT. Duhet të theksohet që kjo nuk synon që t'i japë AKEP-it të drejtën e përzgjedhjes së audituesve, të cilët do të përzgjidhen nga secili sipërmarrës, por që duhet të ketë një komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë midis AKEP-it dhe Sipërmarrësve për raportimin rregullator dhe auditimin e dokumentave të depozituara.

- Sipërmarrësi me FNT duhet të njoftojë AKEP-in për çdo vendim mbi përzgjedhjen e një audituesi, së bashku me detajet mbi objektin dhe planin e auditit, dhe vërtetim për përvojën e duhur përkatëse në fushën e auditit rregullator, për t'i lejuar AKEP-it kohë të mjaftueshme që të komentojë dhe në rast të një kundërshtimi të fortë, t'i kërkojë Sipërmarrësit me FNT të paraqesë një propozim alternativ.
- Çdo ndryshim i propozuar i auditorit të përzgjedhur për llogaritë rregullatore duhet t'i njoftohet AKEP-it të paktën tre muaj përpara fillimit të çdo veprimtarie auditimi dhe nëse është e përshtatshme, duhet organizuar një takim për të diskutuar planet dhe kërkesat.
- AKEP-i do të ketë të drejtën të angazhohet direkt me auditin për të diskutuar proceset përkatëse ose rezultatet e auditimit.

Audituesit e llogarive rregullatore duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë kredencialet që kanë të bëjnë me veprimtaritë e auditimit të korporatave dhe anëtarësimet në institucionet përkatëse profesionale.

Audituesit duhet gjithashtu të demonstrojnë objektivitet të plotë dhe distancim nga çdo lloj angazhimi tregtar, përfshirë punën këshilluese, ndërmjet kompanisë së auditit, kompanive të lidhura dhe Sipërmarrësit me FNT. Kjo dispozitë do të jetë një aspekt kryesor për çdo vlerësim që bëhet nga AKEP-i në lidhje me qëndrueshmërinë dhe pranueshmërinë e audituesve të propozuar.

Kostoja e auditit të pavarur për llogaritë rregullatore do të mbulohet krejtësisht nga Sipërmarrësi me FNT.

3.6 Publikimi

Informacioni rregullator që do të përgatitet dhe do të publikohet nga Sipërmarrësit me FNT në përputhje me detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e koston, do të përmbajë sa më poshtë:

Pasqyra financiare rregullatore	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
	Pasqyra e kapitalit mesatar të punësuar (përdorur)
	Pasqyrat e rakordimit
	Analizë të kostove për njësi
	Raport mbi pagesat e transferimeve
	Deklaratë mbi përgjegjshmërinë
	Opinion i Audituesve
Dokumentet e Kontabilitetit	Parimet e kontabilitetit
	Metodologjitë e revlerësimit të aktiveve
	Përshkrim i modelit të kostos
	Detyjatë të përllogaritjes së WACC
Dokumenti i Metodologjisë së Alokimit	Përshkrim i alokimit të kostove në model
Dokumenta raportues shtesë	Sipas kërkesës së AKEP

Shembuj të raporteve që mbulojnë gjithë aspektet e publikimit janë përfshirë në Shtojcën 2. Pasqyrat e përfshira duhet të kenë nivelin e kërkuar të detajimit për të marrë plotësisht parasysh tregjet, segmentet dhe strukturat e ndara. Dokumentacioni i metodologjisë së alokimit duhet të japë informacion përmbledhës për t'u bërë publik dhe detaje të plota mbi alokimin e kostove të kryera në modelin e kostos, vetëm për AKEP.

Sipërmarrësit me FNT duhet t'i japin AKEP-it variantet elektronike të pasqyrave dhe analizave të kontabilitetit rregullator, në mënyrë që AKEP-i të ndihmohet në objektivat e tij për interpretimin e tyre dhe analizën rregullatore. Kjo do të përfshijë një variant të hollësishëm dhe të detajuar të të gjitha modeleve përkatëse të kostos, të mjaftueshëm që t'a lejojë AKEP-in të testojë metodat dhe supozimet për qëllime të pajtueshmërisë rregullatore. Natyra e saktë e këtyre depozitimeve, të cilat do t'i jepen vetëm AKEP-it, duhet të rrjedhë nga specifikimi i sistemeve individuale dhe një marrëveshje e duhur dhe në kohë ndërmjet AKEP-it dhe entitetit të rregulluar.

3.7 Udhëzim përmbledhës

Më poshtë është paraqitur një pamje e përgjithshme e udhëzimeve të dhëna mbi parimet e kontabilitetit rregullator:

- Llogaritë e ndara duhen bazuar mbi një metodologji transparent të alokim dhe të ndarjes së kostove dhe duhet të zbatojnë konvencionin e kontabilitetit të kostos aktuale.
- Llogaritë e ndara duhet të përfshijnë transferimet ndërmjet njësive të biznesit dhe veprimtarive të pa-agreguara për shërbimet që një organizatë i ofron vetes. Për këtë

arsye transferimet duhen treguar qartë si të ardhura dhe kosto në pasqyrat e njësisë përkatëse të biznesit. Pagesat duhet të jenë të barasvlershme me transaksionet për të njëjtat shërbime me Sipërmarrës të tjerë dhe kjo duhet të demonstrohet në llogaritë rregullatore.

- c) Llogaritë e ndara duhen përgatitur në pajtim me standardet e pranuar të kontabilitetit sa herë që nevojitet.
- d) Llogaritë e ndara duhen përgatitur në pajtim me parimet e caktuara në Seksion 3.2 të këtij dokumenti.
- e) Duhen dhënë hollësi të qarta mbi çdo ndryshim të rëndësishëm që ndikon mbi pasqyrat financiare dhe pasqyrat e vitit të mëparshëm.
- f) Llogaritë e ndara duhen dorëzuar tek AKEP-i çdo vit dhe duhet të përmbajnë informacion krahasues. Ndryshimet materiale në parimet ose politikat e kontabilitetit, metodologjitë e alokimit ose metodologjitë e pagesave për transferimet që ndikojnë informacionin e raportuar në llogaritë e ndara, duhet të pasqyrohen nga një ri-pasqyrim i llogarive të vitit të mëparshëm.
- g) Llogaritë e ndara duhet që të detajojnë në mënyrë eksplicite çdo ndryshim ndërmjet analizës së koston së treguar në pasqyrat financiare rregullatore dhe kostove të përcaktuara nga AKEP-i për qëllime të rregullimit të tarifave dhe orientimit në kosto të tyre.

Llogaritë e ndara duhet t'i nënshtrohen një auditimi të pavarur në përputhje me dispozitat në këtë dokument, praktikën më të mirë e ligjin përkatës në Shqipëri si dhe standardet ndërkombëtare të praktikës më të mirë. Ky audit duhet të tregojë që llogaritë rregullatore dhe informacioni përkatës i dorëzuar në AKEP-i është i saktë dhe i paraqitur drejtë.

4. Parimet e Ndarjes së Llogarive

Për të krijuar kontabilitetin rregullator për të ardhurat dhe kostot e shërbimeve, Sipërmarrësit me FNT nën-rregullim duhet të bëjnë sa më poshtë:

- Të përcaktojnë të ardhurat, kostot, aktivet dhe detyrimet që kanë të bëjnë me secilin shërbim përkatës.
- Të përcaktojnë rregullat dhe kushtet sipas të cilave kostot që kanë të bëjnë me aktivitetet e përbashkëta shpërndahen ndërmjet shërbimeve të ofruara.
- Të dokumentojnë të dhënat dhe rregullat financiare dhe të vëllimit brenda pasqyrave financiare dhe dokumenteve të metodologjisë.

4.1 Metodologjia e alokimit

Pasqyrat financiare rregullatore duhet të tregojnë supozimet mbi të cilat bazohen alokimet e kostos, si dhe marrëdhëniet ndërmjet kostove dhe faktorëve ndikues të tyre.

Pasqyrat do të përfshijnë një rishikim të elementëve dhe aktiviteteve të rrjetit të përdorura për të ofruar shërbime përkatëse, kosto operuese dhe të kapitalit që kanë të bëjnë me to, fitimin përkatës mbi kapitalin e punësuar dhe faktorët e përdorimit për elementët e rrjetit. Këta elementë do të përbëjnë kostot totale të gjithë elementët e rëndësishëm të rrjetit.

Të ardhurat janë të mundshme që të alokohen direkt te produktet ose shërbimet që i ato referohen, duke përdorur si burim informacioni të dhënat financiare dhe rezultatet e sistemit të faturimit. Nëse këto metoda nuk lejojnë alokim direkt, të ardhurat duhen alokuar mbi baza të parimit të shkaktimit.

4.1.1 Procesi i alokimit të kostove

Kategoritë e kostove që do të alokohen te shërbimet mund të përmbliidhen si më poshtë:

- a) Kostot direkte: kosto të shkaktuara vetëm në lidhje me një produkt ose shërbim të veçantë dhe regjistruar si të tilla në sistemet financiare
- b) Kostot e alokuara në mënyrë direkte: kosto të shkaktuara vetëm në lidhje me një produkt ose shërbim të caktuar, por që nuk janë regjistruar si të tilla në sistemet financiare.
- c) Kostot e alokuara në mënyrë indirekte: kosto të cilat janë pjesë e kostove të përbashkëta ose të ndara, por të cilat mund të alokohen te një produkt ose shërbim i veçantë mbi baza të një marrëdhënie të qartë dhe arsyeje të justifikueshme. Procesi për të kryer alokimin mund të përfshijë disa hapa dhe vendim-marrje të arsyeshme dhe subjektive.
- d) Kostot e pa-alokuara: kosto të cilat janë pjesë e kostove të përgjithshme të përbashkëta ose të ndara, por që nuk alokohen te një produkt, shërbim, aktiv ose funksion i veçantë mbi baza të një marrëdhënieje qartësisht të justifikueshme.

4.1.2 "Kaskada" ose hierarkia e alokimit të kostove

Kostot mund të alokohen në shërbime, qendra kostoje që kanë të bëjnë me elementët e rrjetit, te funksione të lidhura ose te funksione të ndara. Përcaktimet për këto janë si më poshtë:

- a) Shërbimet: kostot që identifikohen direkt me një shërbim të veçantë, që mund të jetë një shërbim për përdorues fundor (me pakicë) ose shërbim rrjeti (shumicë).
- b) Elementët e rrjetit: kostot që kanë të bëjnë me transmetimin, komutimin/rrugëzimin dhe me platforma dhe sisteme të tjera të rrjetit. Kostot do të kenë lidhje me elementët e rrjetit të përdorur për të ofruar shërbime të ndryshme, që nuk mund të caktohen direkt te një shërbim.
- c) Funkcionet shoqëruese: kostot e funksioneve të shitjes me pakicë e me shumicë të nevojshme për t'ju ofruar shërbimin klientëve, të tilla si faturimi, mirëmbajtja dhe shërbimi ndaj klientit.
- d) Funkcionet e ndara: kostot e pjesëve të rëndësishme të operacionit të një kompanie që nuk lidhen me ofrimin e shërbimeve të veçanta, të tilla si financa dhe administrimi.

Kostot alokohen midis shërbimeve duke ndjekur një numër hapash për të kompletuar procesin me një metodë përsëritëse. Hapat përdorin nxitësa përkatës të kostove (cost drivers) dhe mund të përmbliidhen si më poshtë:

- 1) Funkcionet e ndara (siç janë përshkruar më lartë) alokohen midis funksioneve shoqëruese, elementëve të rrjetit dhe shërbimeve.
- 2) Kostot e funksioneve shoqëruese alokohen midis shërbimeve dhe elementëve të rrjetit.
- 3) Kostot e elementit të rrjetit alokohen te shërbimet.
- 4) Shërbimet grupohen në tregje ose segmente për të arritur analizën e kërkuar për ndarjen e llogarive.

Sikurse është detajuar në Pjesën 3, metodologjitë e përdorura të alokimit dhe atribuitit duhet të dokumentohen dhe publikohen në mënyrë transparente, të mjaftueshme për ta mundësuar AKEP-in të kuptojë dhe vlerësojë metodat, rezultatet dhe pajtueshmërinë.

Hapat e alokimit që kryhen realisht mund të përfshijnë nën-hapa dhe përsëritje të krijuara për të optimizuar diz-agregimin dhe saktësinë në proces. Është e mundshme që për të analizuar kostot dhe aktivitetet si dhe për të përfunduar alokimin, të përdoren teknika të anketimit dhe marrjes së kampionimit, në pajtim me metodologjitë e krijuara të administrimit dhe llogaritjes së kostos. Objektivi kryesor është që të sigurohet pajtueshmëria me parimin e shkaktimit. Të gjitha hollësitë që kanë të bëjnë me procesin, i duhen dhënë AKEP-it dhe AKEP-i do të ketë të drejtën ta rishikojë procesin dhe të kërkojë ndryshime nëse mendon se nevojiten për të përmirësuar saktësinë e procesit të alokimit.

4.1.3 Shërbimet me FNT dhe pa FNT

Sipërmarrësit që ofrojnë një kombinim të shërbimeve të rregulluara dhe të parregulluara do të gjenerojnë informacion nga sistemet financiare që reflektojnë këtë kombinim. Kjo është e lidhur me kërkesat e ndarjes së llogarive për shkak se pasqyrat financiare rregullatore do të duhet të tregojnë të dhëna për shërbimet pa FNT së bashku me raportimin e detajuar për shërbimet me FNT në mënyrë që të përmbushin detyrimet ligjore.

Pasqyrat financiare rregullatore duhet të rakordohen me pasqyrat e kontabilitetit ligjor; prandaj niveli minimal i detajimit do të paraqesë shërbimet pa FNT si një kategori e përgjithshme për analizim në pasqyrat financiare, deri në masën që pasqyrat janë gjithëpërfshirëse dhe të sakta e që plotësojnë kërkesat për raportimin mbi shërbimet e rregulluara.

Entitetet e rregulluara duhet të adoptojnë një politikë mbi ndarjen ndërmjet shërbimeve me dhe pa FNT për raportimin financiar rregullator, që nuk zbeh dobinë dhe saktësinë e ndarjes së kontabilitetit në asnjë mënyrë ose nuk ndikon negativisht mbi qartësinë e raportimit për

shërbimet me FNT. Kjo politikë nuk duhet të paraqesë asnjë problem të madh pasi kërkesa për rakordim është një aspekt thelbësor i rregullave të ndarjes së llogarive. Sipërmarrësit duhet të jenë të përgatitur që ta diskutojnë këtë aspekt të veçantë të raportimit me AKEP-in brenda procesit të krijuar, për të parandaluar kërkesat e shmangshme të rishikimit dhe të ndryshimit të cilat mund të rezultojnë në rast të kundërt.

Hollësi të tjera mbi transparencën dhe publikimin e informacionit të shërbimeve pa FNT janë përfshirë në Seksionin 6 më poshtë.

4.2 Llogaritja e kostove

Një sistem i llogaritjes së kostos përmban një numër sistemesh, procesesh, politikash dhe procedurash që mundësojnë regjistrimin e të dhënave dhe raportimin, të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat rregullatore. Sistemi përmban rregullat mbi alokimin dhe atribuimin kostove, të të ardhurave dhe kapitalit të përdorur.

Llogaritja e kostove përdoret për të treguar pajtueshmëri me detyrimet e orientimit të kostos për shërbimet e rregulluara dhe përbën një pjesë kryesore të një sistemi të ndarjes së llogarive, si dhe demonstroi zbatimin e parimit të mos-diskriminimit dhe mungesës të subvencioneve të kryqëzuara (të tërthorta) anti-konkurruese.

Llogaritja e kostove varet nga grumbullimi efikas i të dhënave dhe analizave të shëndosha, për të siguruar zbatimin e kriteve të drejta dhe objektive për të prodhuar rezultate me vlerë dhe të besueshme.

4.2.1 Kontabiliteti i Kostos Historike dhe Kontabiliteti i Kostos Aktuale

Kontabiliteti me bazë Kosto Historike (Historical Cost Accounting - HCA) në përgjithësi pranohet si një metodologji e përshtatshme për administrim financiar, e përdorur si e tillë në përgatitjen e pasqyrave financiare ligjore. Megjithatë, HCA nuk është e përshtatshme për vendim-marrje rregullatore dhe për këtë arsye Kontabiliteti me bazë Kosto Aktuale (Current Cost Accounting - CCA) është metodologjia e kërkuar. CCA-ja pranon pasojat e ndryshimit të çmimeve, zhvillimet teknologjike dhe vlerën për një biznes të aktiveve që përdoren për të ofruar shërbime. Përdorimi i CCA kërkon që sipërmarrësit të rivlerësojnë aktivet dhe mbi këtë rivlerësim të prodhojnë pasqyra financiare përkatëse, duke pasqyruar kështu se çfarë do të rezultonte në kushtet e konkurrencës së plotë në treg.

Shumë faktorë mund të kontribuojnë në ndryshimet e vlerave të aktiveve që rezultojnë nga rivlerësimi bazuar në CCA. Aktivitetet e rrjetit, hardueri, pronat dhe zërat e tjera të kapitalit mund të rriten ose ulen në vlerë për shkak të inflacionit të çmimeve, faktorëve ekonomikë dhe ndryshimit teknologjik. Vendimet e marra duhet të jenë të qëndrueshme, transparente dhe të krahasueshme dhe Sipërmarrësit me FNT duhet t'ia tregojnë metodologjitë AKEP-it.

CCA-ja duhet të mundësojë matjen e performancës financiare nga Sipërmarrësit me FNT në mënyrë të qëndrueshme me kostot me të cilat përballen hyrësit e rinj në treg, duke lejuar rikuperimin e kostove aktuale. Zbatimi i CCA-së mund të krijojë fitime ose humbje të konsiderueshme të mbajtura për Sipërmarrësin me FNT, që rezultojnë nga ri-vlerësimi i aktiveve ekzistuese.

Vlerësimi i aktiveve të rrjetit është thelbësor për metodologjitë CCA dhe shpjegimet duhen të jenë transparente dhe të mund të verifikohen nga AKEP-i.

Kostoja Bruto e Zëvendësimit

Kostoja Bruto e Zëvendësimit (GRC) është një përafrim i vlerës së një rrjeti të ri zëvendësues që ofron të njëjtin nivel funksionaliteti dhe kapacitet sikurse ai ekzistues, duke përdorur supozime rreth vlerave të barasvlershme të aktiveve dhe metodologjive përkatëse. GRC-ja mund të mos prodhojë një vlerë të përshtatshme për matjen e performancës financiare.

Kostoja Neto e Zëvendësimit

Kostoja Neto e Zëvendësimit (NRC) mund të përshkruhet si kostoja e zëvendësimit të një aktivi ekzistues me një aktiv tjetër me karakteristika dhe moshë të ngjashme. Kjo vlerë mund të krahasohet me një vlerë teorike të rikuperueshme, që është vlera më e lartë midis vlerës neto të realizueshme të aktivitetit (vlera për ta shitur, minus kostot e shitjes) dhe shumës e rikuperueshme nga përdorimi i ardhshëm i tij (vlera ekonomike ose vlera aktuale neto e rrjedhave të ardhme të parasë që pritet të merren në pjesën e mbetur të jetës së aktivitetit). Vlera më e ulët midis shumës së rikuperueshme dhe NRC përbën vlerën e kompensimit për humbjen e aktivitetit (deprival value), që përfaqëson vlerën e aktivitetit për organizatën dhe mund të përdoret si vlerësimi CCA.

Aktivet Moderne Ekuivalente

Nëse aktivitetet ekzistuese nuk mund të zëvendësohen direkt, vlerësimi i Aktiveve Moderne Ekuivalente (Modern Equivalent Asset -MEA) realizohet duke u mbështetur në atë që sa do të kushtonet për të zëvendësuar aktivitetet ekzistuese me aktive teknikisht të përditësuara me të njëjtin kapacitet shërbimi. Për shkak se teknologjitë e reja zakonisht janë më efikase dhe me funksionalitet më superior, vlerat e MEA-s mund të kenë nevojë për rregullime për të pasqyruar ndryshimet në kostot operacionale dhe në nivelet e kapacitetit për të siguruar ekuivalencën e kërkuar.

4.2.2 Ruajtja e kapitalit

Përcaktimet e ruajtjes së kapitalit kanë të bëjnë me faktin se si shihet kapitali i një kompanie kur përcaktohet rentabiliteti. Kapitali mund të shihet si operacional (kapaciteti për të prodhuar të mirat dhe shërbimet) ose si financiar (vlera e kapitalit të aksionerëve). Këto dy versione njihen si Ruajtja e Kapitalit Operacional (OCM) dhe Ruajtja e Kapitalit Financiar (FCM). Këto dy metodologji mund të krijojnë diferenca të konsiderueshme në kosto dhe në vlerësimin e rentabilitetit.

Parimi kryesor i OCM-së është ruajtja e aftësisë operacionale të kompanisë. Me këtë metodë, kompania duhet të ketë të njëjtën aftësi operacionale në fund të periudhës përkatëse sikurse dhe në fillim. Rentabiliteti arrihet pasi të jenë ruajtur aftësitë fizike.

Parimi i FCM është ruajtja e kapitalit financiar të kompanisë në kushtet e çmimit aktual. Fondet e aksionerëve ruhen në terma reale në fund sikurse në fillim të periudhës. Rentabiliteti arrihet pasi vlera financiare e një aktivi ose biznesi të jetë ruajtur.

Bazuar në OCM, tepricat dhe deficitet në ri-deklarimin e vlerave të aktiveve sipas kostos aktuale pasqyrohen si lëvizje në rezervën e kostos aktuale, sepse ndryshimet në vlerat e aktiveve operacionale janë ndryshime të kapitalit. Bazuar në FCM, fitimet dhe humbjet e mbajtura transferohen në llogarinë e fitimit dhe humbjes. Prandaj informacioni i FCM-së, mund të ri-deklarohet si OCM. E kundërta nuk është aq e drejtpërdrejtë për shkak të natyrës dhe paraqitjes së transaksioneve të bilancit.

Sipas OCM, aktivitetet fikse do të rivlerësohen sipas kostos aktuale. Kjo mund të përfshijë analizat e çmimit ose vlerësimin MEA. Si rezultat, vlerat e amortizuara duhet të ri-deklarohen, për t'u siguruar që ndryshimet janë konsistente me vlerësimet aktuale. Amortizimi shtesë nxirret, duke

përdorur teknika të njohura kontabiliteti, për të pasqyruar ndryshimin midis vlerës së amortizimit me kosto historike dhe asaj me kosto aktuale.

Tabelat e mëposhtme (të publikuara në Udhëzimet e ERG: ERG (05)29) ilustrjnë konceptet e mësipërme për një aktiv të blerë për 10.000 Euro. Jeta e supozuar e aktivit është katër vjet. Supozohet se aktivi amortizohet në mënyrë lineare dhe vlera e mbetur e tij është zero. Në Tabelën 1 është supozuar se kostoja bruto e zëvendësimit të aktivit bie me 10% në vit. Në Tabelën 2 supozohet se kostoja bruto e zëvendësimit rritet me 5% në vit.

Table 1

Replacement cost falling by 10 % per annum

Year	Current Cost	Depreciation					
		Current cost	Historical	Supplementary	Cumulative	'Required'	Backlog
0	10 000						
1	9 000	2 250,00	2 500,00	(250,00)	2 250,00	2 250,00	Nil
2	8 100	2 025,00	2 500,00	(475,00)	4 275,00	4 050,00	(225,00)
3	7 290	1 822,50	2 500,00	(677,50)	5 872,50	5 467,50	(405,00)
4	6 561	1 640,25	2 500,00	(859,75)	7 107,75	6 561,00	(546,75)

Table 2

Replacement cost rising by 5 % per annum

Year	Current Cost	Depreciation					
		Current cost	Historical	Supplementary	Cumulative	'Required'	Backlog
0	10 000,00						
1	10 500,00	2 625,00	2 500,00	125,00	2 625,00	2 625,00	Nil
2	11 025,00	2 756,25	2 500,00	256,25	5 381,25	5 512,50	131,25
3	11 576,25	2 894,06	2 500,00	394,06	8 406,56	8 682,19	275,63
4	12 155,06	3 038,77	2 500,00	538,77	11 720,96	12 155,06	434,10

Derivimi dhe shpjegimi i tabelave të mësipërme :

- kostoja aktuale është kostoja bruto e zëvendësimit të aktivit;
- amortizimi me kosto aktuale është nxjerrë nga raporti i kostos bruto të zëvendësimit në fund të periudhës me jetëgjatësinë e aktivit;

- amortizimi me kosto historike është nxjerrë si raporti i koston fillestare të blerjes me jetëgjatësinë e aktivitetit;
- amortizimi suplementar është vlera e shtuar e amortizimit si rezultat i rivlerësimit të aktivitetit (ajo nxirret nga diferenca midis amortizimit me kosto aktuale dhe amortizimit me kosto historike) – ai mund të jetë pozitiv ose negativ;
- amortizimi i akumuluar është shuma e amortizimit të akumuluar me kosto aktuale në fund të periudhës së mëparshme, amortizimit të prapambetur për periudhën e kaluar dhe amortizimit me kosto aktuale për periudhën aktuale. Kjo është ekuivalente me amortizimin e kërkuar në fund të periudhës së mëparshme plus amortizimin me kosto aktuale për periudhën aktuale;
- amortizimi i 'kërkuar' është amortizimi i akumuluar që do të ishte përfshirë duke pasur parasysh koston aktuale të aktivitetit - me fjalë të tjera, kjo është diferenca midis koston bruto dhe neto të zëvendësimit të aktivitetit; dhe
- amortizimi 'i prapambetur' është diferenca midis amortizimit të kërkuar dhe amortizimit të akumuluar dhe lind kur amortizimi me kosto aktuale i periudhës së mëparshme paraqet një mungesë apo tepëri për shkak të ndryshimeve të çmimit të aktiveve.

FCM-ja kërkon ndreqje të ngjashme me ato të përshkruara më sipër, së bashku me disa të tjera në lidhje me ndryshimin e çmimeve që janë specifike për aktivet dhe efektet e inflacionit mbi fondet e aksionerëve.

Opsionet e zgjedhura për konceptin e mirëmbajtjes së kapitalit janë të rëndësishme për metodologjitë CCA brenda kontabilitetit rregullator dhe kërkesave në lidhje me orientimin në kosto dhe Sipërmarrësit eficientë. Kërkesat për të ardhurat ndryshojnë në varësi të konceptit që përdoret, pasi FCM-ja përfshin fitimet e humbjet e mbajtura dhe ndreqjet e fondeve të aksionerëve së bashku me koston, amortizimin dhe kthimin mbi aktivet.

4.2.3 Kostoja e kapitalit dhe kapitali i punësuar

Sipërmarrësve me FNT ju lejohet një kthim mbi kapitalin e punësuar që ka të bëjë me shërbimet e rregulluara, duke pasur parasysh nivelin e investimeve dhe rrezikun e përfshirë. Kthimi varet nga kostoja e kapitalit dhe vlerat e kapitalit.

Kostoja e kapitalit

Kostoja e kapitalit të një Sipërmarrësi duhet të pasqyrojë koston oportune të fondeve të investuara në një rrjet dhe aktivet përkatëse dhe duhet të përfshijë një nivel fitimi për biznesin.

Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit¹ (ËACC) të një Sipërmarrësi, zakonisht nxirret nga kostoja mesatare e ponderuar e borxhit (për llojet ndryshme të borxhit), kostoja e kapitalit aksionar (fitimi i aksionerëve që reflekton rrezikun), dhe vlerat e borxhit dhe kapitalit të vet (neto). Kostoja e kapitalit aksionar përcaktohet duke përdorur Modelin e Vlerësimit të Aktiveve Kapitale² (CAPM), që merr parasysh fitimet e tregut dhe shkallën e rrezikut të një kompanie. Hollësitë e formulës për këto llogaritje dhe udhëzimet specifike për to janë dhënë në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Përdorimi i këtyre teknikave të pranura për të llogaritur ËACC është relativisht i thjeshtë në raste individuale. AKEP-i duhet të jetë në gjendje të vlerësojë nivelin e ËACC-së së propozuar dhe për këtë do të mbështetet në nivele të larta të transparencës dhe publikimit të procesit që është ndjekur. AKEP-it do t'i kërkohet të vlerësojë nivelin e borxhit dhe kapitalit neto, nivelet e

¹ Në gjuhën angleze: Weighted Average Cost of Capital (WACC). (Shënim i përkthyesit)

² Në gjuhën angleze: Capital Asset Pricing Model (CAPM). (Shënim i përkthyesit)

riskut, koeficientët beta dhe çështjet përkatëse të taksimit. Çdo faktor që nuk mund të llogaritet duke i'u referuar tregjeve Shqiptare do të trajtohet duke i'u referuar krahasimit me tregjet ndërkombëtare në mënyrën e duhur.

Nëse një ËACC konsiderohet i duhur për përdorim në vlerësimin e shërbimeve dhe tarifave të rregulluara, ai do të miratohet si i tillë dhe do të përdoret për të përgatitur pasqyra financiare rregullatore. Brenda këtij regjimi, mund të jetë e nevojshme të bëhen vlerësime të ndryshme të ËACC-ut për segmente të ndryshme të tregut ose pjesë të ndryshme brenda kompanisë. Kjo gjë ndodh vetëm kur ka ndryshime të konsiderueshme në rreziqe dhe kushte, dhe këto çështje duhet t'i nënshtrohen rishikimit të hollësishëm nga AKEP-i në bashkëpunim me Sipërmarrësin me FNT.

Kapitali i punësuar (në përdorim)

Në përgjithësi kërkohet që Sipërmarrësit me FNT të bëjnë një vlerësim të kapitalit mesatar në përdorim për t'a përdorur në vendosjen e çmimeve dhe vlerësime të tjera rregullatore, për të siguruar që janë përdorur nivele përfaqësuese që nuk kanë shtrembërim të përkohshëm. Për këtë arsye në llogaritë e ndara duhet të përdoren llogaritjet mesatare, me të dhëna nga fillimi dhe fundi i një periudhe kontabiliteti.

4.3 Kostoja Shtëse Afat-Gjatë

Kostoja Shtesë Afat-Gjatë³ (e njohur edhe si LRIC), këtu përfshihet edhe Kostoja Shtesë Mesatare Afat-Gjatë (LRAIC), është një metodologji e përdorur për të llogaritur koston e një shtese të përcaktuar të prodhimit, bazuar në koston në perspektivë me të cilat ndeshet një Sipërmarrës eficient. Perspektiva afat-gjatë lejon që të gjitha koston, përfshirë investimet e kapitalit, të trajtohen si të ndryshueshme dhe të shmangshme. Kjo i mundëson rregullatorët që të përdorin këtë metodologjinë për të vendosur çmime të orientuara në kosto në tregun e komunikimeve elektronike, që është i karakterizuar nga nivele të larta të investimeve dhe kosto të pakthyeshme dhe aktive me jetëgjatësi të madhe.

Metodologjia e modelit LRIC lejon nxjerrjen e disa lloj kostonave të shtesave të ndryshme, nga nivelet dysheme të shtesave deri në nivelet tavan të kostonave individuale të pavarura⁴, të cilat mund të japin një interval për matjen dhe vlerësimin brenda mjedisit të rregulluar. Çmimet mund të derivohen që të lejojnë mbulimin e kostonave të përbashkëta dhe nivele efiente operimi.

Për shkak se LRIC kërkon një trajtim të kostonave në perspektivë, metodologjitë CCA janë të përshtatshme për modelin. Për këtë arsye çmimet mund të nxirren nga nivelet më efiente të teknologjisë së disponueshme dhe nga hyrësit e rinj në treg që mund të blejnë akses te një rrjet pa subvencionuar ndonjë inefiçencë aktuale.

Në terma konceptuale, LRIC ka ngjashmëri me koston marzhinale. Kostoja marzhinale është vlera e njësisë së fundit të prodhimit, kurse shtesa (inkrementi) është vlera e rritjes në koston totale si rezultat i shtesës (inkrementit). Kjo e fundit konsiderohet si më e përshtatshme për të përcaktuar çmimet për shërbimet e komunikimeve elektronike, duke siguruar mbulimin e kostonave të përbashkëta, duke pasur parasysh ekonomitë e shkallës dhe kushtet e përgjithshme.

³ Në gjuhën angleze: Long Run Incremental Cost (LRIC). (Shënim i përkthyesit)

⁴ Në gjuhën angleze: Standalone costs. (Shënim i përkthyesit)

4.3.1 Inkrementi

Shtesa (inkrementi) e LRIC mund të jetë një njësi e vetme e prodhimit, një grup produktesh ose segment tregu ose një gamë e tërë produktesh brenda një njësie biznesi. Në terma matematike, kostoja inkrementale mund të llogaritet si kostot totale të prodhimit përfshirë inkrementin minus kostot totale të prodhimit duke e përjashtuar inkrementin (shiko Seksionin 4.3.4 më poshtë mbi LRIC-në e pastër.)

Për këtë arsye inkrementi LRIC mund të përcaktohet si kostoja shtesë e ofrimit, kur të gjithë faktorët e tjerë mbeten të njëjtë, ose si kostoja totale e shmangshme nga ndalimi i ofrimit të njësisë së shërbimit.

4.3.2 Modelimi i kostove LRIC

LRIC përdoret shpesh për të vendosur tarifat për shërbimet e aksesit dhe interkoneksionit të Sipërmarrësve me FNT në tregjet e komunikimeve elektronike, sikurse është tashmë rasti i Shqipërisë. Modelimi mund të përdoret për të përcaktuar nivelet e kostos eficente, duke marrë parasysh objektivat për konkurrencën dhe përfitimet e konsumatorëve si dhe parandalimin e problemeve të ngushtimit së marzheve (margin squeeze). Rregullatorët mund të përdorin metoda lart-poshtë (top-down) ose poshtë-lart (bottom-up) për të përcaktuar kostot, por zakonisht përdorin metodën poshtë-lart.

Metodat lart-poshtë fillojnë me informacionin e kontabilitetit të kompanisë dhe llogarisin koston e inkrementeve duke përdorur marrëdhëniet kosto-vëllim dhe nivelet e përpunimit për ta përfunduar modelin. Kjo metodë kërkon CCA dhe supozime të duhura mbi nivelet e eficensës.

Një metodë poshtë-lartë fillon me supozime të kërkesës dhe ndërton një rrjet eficient dhe model inxhinierik për të plotësuar kërkesën. Modeli zgjerohet për të analizuar përdorimin e elementëve dhe mundëson përcaktimin e vlerave të inkrementit. Mund të përdoret edhe një metodë hibride, duke ndërtuar dy llojet e modelit për të siguruar vendime të sakta dhe për të kontrolluar eficensën.

Modelet LRIC përmbajnë supozime mbi disa parametra kryesore që përdoren si inpute. Këto përfshijnë nivele të lejueshme të in-efiçencës, nivelet e fitimit dhe nivelet e rikuperimit të kostove të përbashkëta. Një rregullator mund t'i përdorë këto supozime për të arritur objektivat e politikës rregullatore dhe zbatimin e modelit.

4.3.3 Matja e kostove

Përdorimi i modelimit LRIC brenda regjimeve rregullatore dhe nga bizneset e rregulluara përfshin metoda të ndryshme për matjen e kostos që së bashku, mundësojnë një vlerësim më të besueshëm dhe rigoroz dhe rritje të konfidencës në efektshmërinë rregullatore. Matjet alternative të kostos përshkruar këtu më poshtë duhet të prodhojnë çmime "dysHEME" dhe "tavan", të cilat mund të përdoren për të siguruar pajtueshmëri me detyrimet rregullatore.

Kosto individuale e pavarur (Stand-Alone Cost: SAC) është kostoja e ofrimit të një inkrementi, duke mos ofruar asnjë inkrement tjetër. Kjo do të thotë se të gjitha kostot e përbashkëta janë përfshirë në SAC për një inkrement të vetme, që është një koncept teorik i cili duhet të prodhojë koston më të lartë për njësi të mundshme për një shërbim të veçantë.

Kostoja Plotësisht e Alokuar (FAC) është kostoja për ofrimin e një inkrementi, ku të gjitha kostot e Sipërmarrësit alokohen plotësisht brenda modelit. Për këtë arsye, disa pjesë të kostove të përbashkëta do të alokohen te inkrementi në fjalë. Alokimi i kostove brenda modelit do të bëhet në mënyra të ndryshme, shpesh mbi baza proporcionale që janë të lidhura me nivelet e kostove

direkte të vlerësuara fillimisht. Modelimi FAC zakonisht do t'i ngjajë së tepërmi modelimit financiar të kontabilitetit të drejtimit të përdorur në biznese për vendim-marrje.

Këto koncepte kostosh përdoren së bashku me LRIC-në për t'i ndihmuar rregullatorët dhe Sipërmarrësit të analizojnë kostot brenda një mjedisi rregullator dhe si rrjedhojë të vendosin çmimet. LRIC-ja shpesh përshkruhet si cmimi dysheme, duke qenë se ai është niveli më i ulët i matjes së kostove që arrin mbulimin e kostove inkrementale. SAC-ja konsiderohet të jetë cmimi tavan, më i lartë se LRIC-ja dhe që përfshin mbulimin e të gjithë kostove të përbashkëta përkatëse. Ndërmjet të dyjave, FAC ofron një opsion të tretë, duke alokuar një pjesë të duhur të kostove të përbashkëta.

Vlerësimet e dyshemesë së kostos dhe tavanit të kostos mund të përdoren brenda disa regjimeve të caktuara rregullatore, ku përdoret modelimi LRIC por nuk është vendosur çmim specifik. Fakti që një çmim është ndërmjet kufijve të ulët dhe të lartë mund të tregojë se ai është i orientuar në kosto dhe është në përputhje me detyrimet rregullatore. Kjo metodë mund të gjendet në regjime rregullatore ku kontrollet e çmimit zbatohen mbi grupe shërbimesh dhe modelet krijohen për të provuar përputhshmërinë. Atje ku çmimet mbështeten në LRIC, përfshi një marzh për kostot e përbashkëta, nevojitet më shumë argumentim për të provuar orientimin në kosto. Për të përmirësuar analizën mund të përdoret testimi kombinues, që krahason të ardhurat dhe vlerësimet e kostos nga baza të ndryshme.

4.3.4 LRIC-ja e "Pastër"

Rekomandimi i BE-së i Majit 2009 për tarifat e terminimit të telefonisë fikse dhe celulare (2009/396/EC) përcakton një metodë për orientimin në kosto dhe rregullimin e tyre, të hartuar për të harmonizuar qasjet rregullatore, për të rritur konkurrencën dhe për të nxitur mirëqenien e konsumatorëve. BE-ja rekomandoi vlerësimin e kostos mbështetur në modelimin LRIC poshtë-lart, duke përfshirë parimet e neutralitetit teknologjik dhe eficensës. Modeli i pastër LRIC përcakton si inkrement, terminimi i thirrjeve zanore me shumicë, ku kostot e lejueshme janë ato të shmangshme nga mos-prodhimi i inkrementit. Rikuperimi i kostove të përbashkëta përjashtohet nga ky model, i cili presupozon se të gjitha kostot fikse janë të ndryshueshme në një periudhë afat-gjatë.

Komisioni Evropian vendosi objektiva në rekomandimin e 2009-s, për t'u zbatuar në gjithë BE-në, me disa përjashtime për rrethana të jashtëzakonshme dhe asimetri në tregjet në tranzicion. Rekomandimi është zbatuar gjerësisht në BE dhe në rajonet përreth, përfshi Shqipërinë (shiko Seksionin 2 më sipër).

LRIC-ja e pastër është një evolucion i metodologjive të krijuara kohë më parë, që është hartuar për të trajtuar çështje specifike për konkurrencën dhe tarifa rreptësisht të orientuara në kosto për të arritur objektivat rregullatore. Ka të ngjarë që të jetë pjesë e detyrimeve që përbëjnë një paketë brenda një regjimi të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostove, që kanë të bëjnë me masa rregullatore të përcaktuara veçmas.

4.3.5 Zbatimi i LRIC-së në praktikë

Vendimi për të përdorur LRIC-në brenda një regjimi rregullator përfshin shumë opsione nga ana e rregullatorit, të cilat mbulojnë aspekte të metodologjisë, procesit dhe rezultateve. Në Shtojcën 1 më poshtë janë dhënë udhëzime specifike dhe në këtë seksion është dhënë një përmbledhje e përgjithshme e fushave përkatëse.

Periudhë afatgjatë, në perspektivë

Afat-gjatë është hapësira kohore gjatë së cilës një Sipërmarrës mund të rrisë ose ulë kapacitetin prodhues. Hapësira afat-gjatë e përdorur do të thotë se të gjitha kostot, përfshi

rrjetin dhe pajisjet kapitale janë mundësisht të ndryshueshme. Për më tepër, kostot "në perspektivë/të ardhmen" duhet të jenë ato me të cilat ndeshet një Sipërmarrës eficient, për të pasqyruar sa më mirë bazën e kostos që ekziston në një mjedis konkurrues. Për të arritur në këto lloj vlerësimesh dhe për të prodhuar rezultatet e dëshiruara të orientuara në kosto, duhet të përdoren kostot aktuale dhe parimet MEA.

Topologjia e rrjetit

Modelet LRIC kërkojnë që supozimet të bëhen mbi topologjinë e rrjetit që mund të ndryshojë në përputhje me metodologjinë e saktë. Pika kryesore e vendimit ka të bëjë me konceptet e metodave të "tokës së djegur"⁵ dhe "nyjës së djegur"⁶ për krijimin e rrjetit. Nyja e djegur e lejon një model të reflektojë topologjinë ekzistuese të rrjetit, kurse toka e djegur përfshin modelimin për një topologji ideale të rrjetit. Në modelimin nga lart-poshtë, një Sipërmarrës mund të modelojë kostot mbështetur në rrjetin ekzistues (nyja e djegur e modifikuar).

Në shumicën e shembujve, pika e nisjes për modelimin LRIC do të jetë një rrjet ekzistues, për arsye praktikiteti dhe realizueshmërie. Për të siguruar plotësimin e objektivave në lidhje me eficensën dhe optimizimin teknologjik, mund të bëhen modifikime mbi një bazë progresive, për të arritur në një pamje të modifikuar që përmbush objektivat rregullatore. Çështjet për t'u trajtuar do të përfshijnë pikat e prezencës, teknologjinë e komutimit, kapacitetin rezervë dhe kostot e aktiveve të ngrira. Nëse ky proces nuk është i mundur ose nuk është praktik për t'u zbatuar në modelimin LRIC, atëherë duhet të ndiqet metoda e tokës së djegur.

Vendimet për inkrementin

Sikurse u përshkrua më parë, modeli LRIC nxjerr kostot e shkaktuara nga ofrimi i një inkrementi të përcaktuar të prodhimit; prandaj është e nevojshme që të vendoset se çfarë inkrementi duhet të përdoret. Inkrementet mund të jenë të vogla ose mëdha, të lidhura me grupet e shërbimit, njësitë e biznesit ose i gjithë aktiviteti në tërësi. Aspekti kryesor i këtij vendimi është që analiza rezultuese të jetë e përshtatshme për qëllimin, duke dhënë të dhëna që do të tregojnë pajtueshmëri me detyrimet e orientimit në kosto dhe që ai të jetë në nivelin e duhur të diz-agregimit. Është e rëndësishme të dihet se vendimet mbi inkrementet duhet të kombinojnë kërkesat për orientimin në kosto me konsideratat se çfarë është praktike për t'u zbatuar.

Marrëdhëniet Kosto-Vëllim

Marrëdhëniet Kosto-Vëllim (CVR) identifikohen si pjesë e procesit të modelimit të kostove. Një shtytës i koston (cost driver) është faktori i përcaktuar që shkakton koston të pësohet dhe CVR i referohet mënyrës në të cilën kostot ndryshojnë me ndryshimin e vëllimi të një shtytësi të koston.

Kostot e përbashkëta

Kostot e përbashkëta nuk janë specifike për inkrementet dhe mund të grupohen si fikse në lidhje me vëllimin ose të lidhura me më shumë se një inkrement në proporcione fikse. Kostot e përbashkëta nuk janë të shmangshme, përveçse kur ndalojnë të gjitha veprimtaritë me të cilat ato kanë lidhje. Modelet LRIC tradicionalisht lejojnë shtimin e një marzhi në koston inkrementale për të lejuar rikuperimin e kostove të përbashkëta. Metodologjia e zakonshme për këtë është metoda e Marzhit Proporcional të Barabartë⁷ (EPMU), e cila përdor një metodë të drejtpërdrejtë të përqindjes së marzhit në proporcion me koston direkte inkrementale që ka dalë

⁵ Në gjuhën angleze: 'scorched earth' (Shënim i përkthyesit)

⁶ Në gjuhën angleze: 'scorched node' (Shënim i përkthyesit)

⁷ Në gjuhën angleze: Equal Proportionate Mark-Up (EPMU). (Shënim i përkthyesit)

tashmë. Kjo metodë është relativisht e thjeshtë, por mund të paraqesë disa pasaktësi në regjistrimin e marrëdhënies ndërmjet produkteve dhe konsumit të kostos së përbashkët, për shkak të alokimit arbitrar. Pavarësisht kësaj, EPMU në përgjithësi pranohet si një metodologji, veçanërisht pasi alternativa të tilla si vendosja e çmimit sipas metodës Ramsey (mbështetur mbi elasticitetin e kërkesës) kanë të ngjarë të jenë të papërshtatshme për zbatimin praktik rregulator.

4.4 Pagesat e transferimeve

Pagesat për transferimet janë veprimet që ndodhin ndërmjet njësive ose departamenteve të paagreguara të një organizate të integruar vertikalisht. Në rastin e kompanive të komunikimeve elektronike të rregulluara, pagesat më të konsiderueshme janë ato kryera për shërbimet e shitjes me shumicë nga niveli i sipërm i operacioneve të rrjetit për te niveli me pakicë i klientëve fundorë. Sistemi i pagesave të transferimeve duhet të jetë transparent, i specifikuar qartë dhe i verifikueshëm që t'i shërbejë qëllimit të mos-diskriminimit dhe të mundësojë orientimin efektiv në kosto.

Pagesat për transferimet duhet t'i ngjajnë shumë ose duhet të jenë identike me pagesat ekuivalente të jashtme për të njëjtin shërbim. Ato duhet të jenë të justifikueshme, me një arsyetim të qartë dhe krejtësisht transparente brenda llogarive të ndara. Pasqyrat dhe raportet duhet të tregojnë që biznesi i shitjes me pakicë në një njësi të rregulluar po paguan të njëjtat tarifa për inputet e shitjes me shumicë sikurse klientët e jashtëm konkurrentë.

Raportimi mbi pagesat për transferimet duhet të përmbajë përshkrime gjithëpërfshirëse të njësive të produktit dhe shërbimit, nivele të veprimtarisë, bazat e pagesave, politikat e kontabilitetit dhe informacionin përkatës mbi koston. Ato duhet të trajtojnë në mënyrë specifike nevojën për të demonstruar trajtim të baravartë ndërmjet klientëve të jashtëm e të brendshëm.

Shtojca 2 e këtij dokumenti përcakton formatet shembuj për raportet e pagesat e transferimeve që pranohen nga AKEP-i dhe që plotësojnë kërkesat për transparencë dhe përfaqësim gjithëpërfshirës. Ato përcaktojnë tregjet dhe shërbimet që duhen pasqyruar në raportimin e transferimeve, duke raportuar kështu siç duhet mbi aspektet e kostos dhe çmimit si dhe organizimin e tregtisë mos-diskriminuese.

Raportet e transferimeve duhet të rakordohen me pasqyra të tjera përkatëse të llogarive të ndara dhe kontabilitetit ligjor, me çdo pasqyrë të nevojshme të rakordimit të përfshirë në pasqyrat e duhura.

4.5 Rakordimi

Sistemi i ndarjes së llogarive duhet të përfshijë një pasqyrë rregullatore të rakordimit që tregon konsistencë ndërmjet kontabilitetit ligjor dhe pasqyrave financiare rregullatore. Aftësia e një entiteti të rregulluar që ta prodhojë këtë, është e lidhur ngushtë me sigurimin e kontroleve dhe procedurave të duhura financiare, si dhe krijimin e sistemeve me aftësi për të krijuar informacionin e kërkuar.

Një shembull i një raporti rakordimi është përfshirë në Shtojcën 2 të këtij dokumenti.

Pasqyra rregullatore e rakordimit duhet të përmbajë raportim financiar të mjaftueshëm për të demonstruar konsistencë ndërmjet llogarive ligjore HCA dhe llogarive rregullatore CCA, që trajtojnë pasojat e rivlerësimit të kapitalit dhe pagesave të transferimeve.

Pasqyra e rakordimit do të formojë një pjesë të rëndësishme të informacionit përdorur nga audituesit për të vlerësuar pajtueshmërinë dhe për të audituar pasqyrat financiare.

4.6 Auditi

Dispozitat dhe rregullat për caktimin e audituesve rregullatorë janë përmendur më sipër në Seksion 3. Shtojca 2 përmban një shembull të një opinionit auditiv, i cili përmban nivelin e hollësive dhe formën e fjalëve që kërkohet.

Raporti i auditit duhet të përfshijë një përfundim, të dhënat e plota të çdo parregullsie të identifikuar, rekomandimet e bëra nga auditit (nëse ka) dhe një përshkrim të metodologjive të përdorura për verifikimin.

Pasqyrat e pajtueshmërisë së auditit dhe rezultatet e tjera duhen prodhuar në një format të thjeshtë dhe duhen botuar nga Sipërmarrësi me FNT në mënyrë që të mund të përdoren nga AKEP-i dhe aktorët e tjerë kryesorë.

Kostoja e auditimit rregullator duhet të mbulohet krejtësisht nga Sipërmarrësi me FNT dhe duhet që edhe të merret parasysh si faktor për vlerësimin e proporcionalitetit në lidhje me masat përkatëse rregullatore.

Elementet kryesore që kërkohen të trajtohen nga auditit janë si më poshtë:

- Objekti i kostos i përfshirë në model dhe alokimi i kostove për produktet dhe shërbimet e rregulluara.
- Rakordimi midis modelit të kostos dhe llogarive ligjore dhe midis llogarive ligjore dhe atyre rregullatore.
- Saktësia e të dhënave dhe shifrave, që përfshin sasitë dhe çështjet teknike.
- Metodologjitë për llogaritjen dhe rivlerësimin e kapitalit, amortizimit dhe alokimin e kostove.
- Pagesat për transferimet.

Sipërmarrësi me FNT i audituar duhet të ofrojë akses në të gjitha të dhënat, sistemet dhe dokumentacionin përkatës për të mundësuar që të kryhet detyra e auditit. Sipërmarrësi me FNT po ashtu duhet që të vërë në dispozicion burimet dhe personelin e duhur gjatë procesit të auditimit për t'ju përgjigjur çdo pyetje që del nga kontrolli.

5. Integriteti dhe Mirëmbajtja e të Dhënave

Është e rëndësishme që të dhënat e përdorura për të përgatitur pasqyrat rregullatore të përmbushin kërkesat e integritetit. Sipërmarrësit e rregulluar janë përgjegjës për të siguruar që të dhënat të jenë paraqitur në sistemet e informacionit dhe mbikëqyrja duhet futur në funksionet ligjore dhe të pajtueshmërisë brenda Sipërmarrësve me FNT.

Integriteti i të dhënave sigurohet edhe nëpërmjet disponueshmërisë së të dhënave dhe sistemeve mbështetës që e lejojnë një audit të kryejë teste dhe verifikime në mënyrën e kërkuar.

Pasqyrat financiare rregullatore duhet të vihen në dispozicion të AKEP-it për të mundësuar vëzhgimin e pajtueshmërisë me detyrimet rregullatore. Këto duhet të dorëzohen çdo vit në pajtim me rregullat e përcaktuara në këtë dokument dhe formatet në Shtojcën 2. Informacioni duhet të ofrohet edhe pas kërkesës në lidhje me hetimet nga AKEP dhe analizës së çështjeve specifike që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe sjelljen e mundshme anti-konkurrese. Këto mund të dalin nga rutina normale e vlerësimit të pajtueshmërisë së AKEP, vendime të jashtëzakonshme të hetimit të tregut ose si rezultat i ankesave dhe kërkesave të bëra nga pjesëmarrësit e tregut.

Informacioni financiar duhet mbajtur nga Sipërmarrësit me FNT në pajtim me legjislacionin kombëtar për çështje të tilla, në mënyrë që mundësia e AKEP-it për të përdorur të dhënat dhe për të kryer analizat pas fundit të një periudhe të raportimit, të mos pakësohet në ndonjë masë të ndjeshme.

Atje ku të dhënat hiqen nga sistemet, duhen mbajtur në një formë dokumentare për t'i mundësuar audituesit dhe AKEP-in të kryejnë nivele të arsyeshme pyetjesh dhe hetimesh pas përfundimit të periudhës përkatëse. Këto të dhëna duhen mbajtur për një minimum prej pesë vitesh të plota financiare.

6. Publikimi dhe Pajtueshmëria

6.1 Transparenca

Shqipëria ka zhvilluar ligjet dhe rregullat për komunikimet elektronike për të pasqyruar dispozitat e kuadrit rregullator të BE-së. Neni 5 i Direktivës Kuadër të BE-së kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë që ndërmarrjet përkatëse të ofrojnë informacionin e nevojshëm, përfshi informacionin financiar, për rregullatorët që t'i mundësojë të sigurojnë njëtrajtshmëri dhe pajtueshmëri me dispozitat e Direktivave. Informacioni i kërkuar duhet të jetë proporcional me kryerjen e kësaj detyre dhe Neni përfshin dispozitat për konfidencialitet dhe përdorimin publik. Ligji shqiptar 9918 (dhe ndryshimet përkatëse të mëtejshme) pasqyrojnë kuadrin e BE-së (në veçanti, shiko Nenin 41 në lidhje me ndarjen e llogarive).

AKEP-i dhe audituesit rregullatorë duhet të kenë mundësinë e përdorimit të informacionit të nevojshëm për t'i mundësuar të kryejnë detyrat e tyre përkatëse në lidhje me ndarjen e llogarive, llogaritjen e kostos, kontrollet e çmimit dhe mos-diskriminimin. Ata kanë për detyrë të sigurojnë konfidencialitet, veçanërisht në lidhje me informacion me ndjeshmëri komerciale dhe ndaj konkurrentëve, të cilat duhet të trajtohen në përputhje me rregullat e BE-së dhe ato kombëtare.

Sipërmarrësit e rregulluar që kanë detyrim t'i paraqesin AKEP-it dhe audituesve pasqyra financiare rregullatore, të dhëna të tjera financiare dhe dokumente shoqëruese përshkruese të metodologjisë, duhet të sigurojnë që të gjitha materialet të jenë transparente dhe të përgatitura në mënyrë që një përdorues i informuar në mënyrë të arsyeshme të mund të kuptojë dhe përdorë atë që është ofruar siç duhet. Kjo do të përfshijë strukturën e sistemeve financiare dhe raportimeve, paraqitjen e pasqyrave përkatëse, përshkrimet dhe shpjegimet që kanë të bëjnë me metodologjitë e kostove e proceset përsëritës të caktimit dhe hollësitë mbi ndarjet, shërbimet dhe pagesat e transferimit.

Transparenca është kritike për aftësinë e autoriteteve rregullatore që të analizojnë të dhënat dhe informacionin e dorëzuar dhe të marrin vendimet rregullatore mbështetur në to. Detyrimet rregullatore që kanë të bëjnë me sistemet financiare dhe llogaritjen e kostos kërkojnë dhënie të konsiderueshme të të dhënave të kompanisë, por duhet që të jenë gjithnjë proporcionale me detyrën rregullatore të monitorimit dhe zbatimit të pajtueshmërisë me këto detyrime.

6.2 Konfidencialiteti

Sikurse u përshkrua, Direktiva e BE-së vendos një përgjegjësi mbi rregullatorët për të siguruar konfidencialitetin e biznesit në kuadrin e transparencës dhe funksionimit të regjimeve rregullatore. Është e rëndësishme që kjo gjë të trajtohet në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurohen Sipërmarrësit me FNT që informacioni konfidencial e sensitiv që atyre ju kërkohet t'i japin AKEP-it do të mbetet konfidencial dhe nuk do t'i jepet publikut në mënyrë që të shkaktojë disavantazh në konkurrencë.

AKEP-i do t'u lejojë Sipërmarrësve me FNT të demonstrojnë që informacioni është sensitiv nga ana tregtare, duke paraqitur provat kontribuese dhe duke diskutuar përpara çdo vendimi dhe publikimi. Për të ndikuar në ndryshimin e këtyre vendimeve duhet demonstruar një nivel material i mundshëm i dëmtimit tregtar.

6.3 Publikimi

Sikurse është përmendur më sipër, kërkesat e BE-së dhe ato kombëtare janë përcaktuar për të siguruar mbrojtjen e informacionit konfidencial në lidhje me publikimin e të dhënave dhe përshkrimin e dokumenteve mbështetëse. Ekzistojnë edhe dispozita të tjera në lidhje me përdorimin publik në këtë informacion. Neni 5 i Direktivës Kuadër të BE-së i jep rregullatorëve fuqinë për të publikuar një informacion të tillë pasi ai do të kontribuojë për një treg të hapur dhe konkurrues. Kjo është pasqyruar në Nenin 41 të Ligjit 9918 në Shqipëri. Dispozitat të lidhura me këtë janë përfshirë në Direktivën e Aksesit të BE-së. Neni 9 trajton ofertat referencë për aksesin dhe interkoneksionin, Neni 11 ndarjen e llogarive dhe të drejtën e rregullatorëve për të publikuar, ku kjo gjë do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës dhe Neni 13 trajton publikimin në lidhje me detyrimet e ndarjes së llogarive.

Objektivi i kërkesave të publikimit për detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen kosos është që të tregojë pajtueshmëri me rregullat dhe t'u japë konfidencë konkurruesve dhe aktorëve kryesorë që Sipërmarrësit me FNT nuk përfitojnë nga subvencionet anti-konkurrencë ose sjellja diskriminuese. Informacioni i disponueshëm për publikun duhet të jetë i mjaftueshëm që ta arrijë këtë objektivi dhe duhet të përfshijë të dhëna dhe dokumentacion në lidhje me detyrimet e FNT, që kryesisht i nënshtrohet paraqitjes së plotë sipas përcaktimit. Duke pasur këtë gjë në mendje, Shtojca 2 e këtij dokumenti (së bashku me Seksion 7 më poshtë) jep hollësi të mëtejshme mbi nivelin e publikimit të pritur nga AKEP-i në lidhje me secilin element të depozitimit të pasqyrave dhe informacioneve financiare rregullatore. Qëllimi është që kjo të plotësojë kërkesat e pajtueshmërisë dhe nxitjen e konkurrencës, si dhe të mbrojë çdo konfidencialitet tregtar të nevojshëm nga ana e Sipërmarrësve të rregulluar.

Sipërmarrësit e rregulluar do ta ruajnë aftësinë për të ngritur shqetësime dhe për të hyrë në diskutime me AKEP-in në lidhje me sensitivitetin dhe konfidencialitetin tregtar si pjesë e procesit të rregullt të përgatitjes së informacionit dhe paraqitjes së tij.

6.4 Tregjet përkatëse

Kuadri i BE-së dhe ligji shqiptar lejojnë përcaktimin e tregjeve përkatëse në përputhje me rekomandimet dhe dispozitat për analizat e tregut. AKEP-i ka botuar rregullat për analizën e tregut, të cilat mund të ndryshojnë, si dhe analizat e tregut që kanë rezultuar në imponimin e detyrimeve rregullatore.

Atje ku janë vendosur detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kosos mbi Sipërmarrësit FNT, është i nevojshëm një lloj niveli i vlerësimit të kosos në tregjet pa FNT, si dhe vlerësimi i kostove të përbashkëta pasi ato kanë lidhje me të gjitha veprimtaritë dhe alokohen ndërmjet tyre. Neni 16 i Direktivës Kuadër të BE-së lejon që autoritetet rregullatore të vendosin detyrime specifike rregullatore mbi Sipërmarrësit FNT kur një treg nuk është konkurrues në mënyrë të efektshme dhe kjo mund të përfshijë dispozitat e ndarjes së llogarive në lidhje me tregjet ku nuk gjenden FNT. Arsyeja për këtë lloj dispozite duhet të jetë që të mbështesë rregullatorin për të kryer detyrat rregullatore, për të siguruar mos-diskriminim dhe transparencë dhe për të arritur një nivel diz-agregrimi dhe raportimi të mjaftueshëm për detyrën. Ky imponim duhet të jetë në raport të drejtë dhe i justifikueshëm në mënyrë të tregueshme, në pajtim me dispozitat e Direktivave.

AKEP-i do të ushtrojë kopetencat që ka për të grumbulluar informacionin, në mënyrë propocionale në lidhje me tregjet pa FNT, për të mbështetur objektivat rregullatore të tregjeve jo-konkurruese dhe masat rregulluese shoqëruese për FNT. Atje ku entiteteve të rregulluara u duhet të raportojnë mbi tregjet dhe shërbimet pa FNT për të plotësuar detyrimet për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kosos, AKEP-i i përcakton hollësitë në Shtojcën 1 të këtij dokumenti

dhe formatet shembuj të raportimit në Shtojcën 2 që përfshin kërkesat përkatëse të paraqitjes. Aksesit në informacionin për tregjet pa FNT mundet që po ashtu të jetë jetike për aftësinë e AKEP-it për të hetuar mosmarrëveshjet në lidhje me mos-diskriminimin dhe barazinë e aksesit në shërbimet me shumicë.

Sipërmarrësit me FNT në Shqipëri kanë të ngjarë të operojnë në tregje konkurruese si dhe në tregje jo-konkurruese, për të cilat kanë të bëjnë detyrimet e tyre të FNT. Ata po ashtu kanë të ngjarë të shfaqin karakteristika të integritit vertikal, në një masë më të madhe ose më të vogël, përfaqësuar nga shërbime dhe portofole të produktit të diferencuara, struktura të departamenteve, ekonomi të shkallës dhe hapësirës dhe nivele të konsiderueshme të kostove indirekte dhe të përbashkëta. Këto kushte nënkuptojnë që analizimi i të ardhurave, kostove dhe kapitalit të punësuar duhet të marrë parasysh alokimin në gjitha produktet dhe shërbimet me FNT dhe pa FNT që mund të tregohen në një mënyrë që ruan sigurinë për saktësinë, integritetin dhe plotësinë e informacionit. AKEP-i duhet të kuptojë marrëdhëniet e kostos të gjithë operacionet për një sipërmarrje të rregulluar dhe të vlerësojë ndikimin e shërbimeve pa FNT mbi shërbimet e rregulluara. Kjo kërkon dukshmëri dhe alokime të kostove dhe trajtimin e kostove të përbashkëta që mund të demonstrojnë mos-diskriminim dhe barazi të aksesit në lidhje me pagesat për transferimet ndërmjet departamenteve të shitjes me shumicë dhe atyre me pakicë.

Rezultati i dispozitave të përfshira më sipër dhe parimet e shqetësimet e paraqitura që kanë të bëjnë me raportimin mbi shërbimet pa FNT, duhet të jetë që objektivat e këtyre rregullave dhe udhëzimeve për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos, të arrihen në lidhje me qartësinë mbi alokimin e kostove në gjithë portofolin e sipërmarrësit të rregulluar, plotësinë e verifikueshme të të dhënave financiare të raportuara dhe sigurimin e integritetit dhe gjurmimit si për AKEP ashtu dhe për audituesit.

7. Afatet kohore

7.1 Këshillimi dhe implementimi

Këto rregulla dhe udhëzime ishin objekt i një konsultimi publik, i cili përfshiu angazhimin direkt me palët e interesuara dhe paraqitjen e propozimeve nga AKEP-i dhe përfaqësuesit e tij.

Dokumenti përfundimtar për implementim është hartuar në vijim të analizës së përgjigjeve ndaj konsultimit dhe përfshin qëndrimet dhe veprimet e AKEP-it ndaj komenteve.

Qëllimi është që rregullat dhe udhëzimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostove, mbuluar nga ky dokument të përfundohen deri në fund të vitit 2013, e më pas të sigurohet zbatimi nga Sipërmarrësit FNT dhe AKEP-i, gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm e në vijim.

7.2 Tranzicioni

Secili Sipërmarrës me FNT në Shqipëri që preket nga këto rregulla do të përballlet me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me zbatimin e këtyre detyrimeve rregullatore edhe pse detyrimet ekzistuese në lidhje me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos si dhe kontrollin e tarifave duhet të lejojnë një përgatitje të efektshme. Ndër problemet që mund të dalin përfshijnë burimet në funksionet financiare, kërkesat e sistemeve dhe çështjet e zbatimit e të udhëheqjes dhe diskutimet me AKEP-in në lidhje me pajtueshmërinë dhe paraqitjen. Dispozita e tranzicionit është e rëndësishme për tu marrë në konsideratë nga AKEP-i, në mënyrë që planet të mund të lejojnë pjesëmarrjen e të gjitha palëve dhe që të mos ketë vonesa ose ndërprerje të panevojshme.

Tabela e mëposhtme tregon migrimin që AKEP-i pret të adoptohet në lidhje me zhvillimin e metodave të reja për llogaritjen e kostove dhe metodologjive për llogaritjen e kostos brenda procesit të ndarjes së llogarive për të gjithë Sipërmarrësit me FNT në Shqipëri. Ky tranzicion merr parasysh nevojat e Sipërmarrësve për të zhvilluar aftësitë e tyre në zhvillimin e Llogarive Rregullatore.

Afati kohor	Baza e kostove	Metodologjia e llogaritjes së kostove
Dorëzimi i vitit të parë	HCA	FAC
Dorëzimi i vitit të dytë	CCA	LRIC
Dorëzimet e viteve të mëtejshme	CCA	LRIC

Pasi kanë pasur mundësinë të kontribuojnë në zhvillimin e këtyre detyrimeve rregullatore gjatë fazës së këshillimit të përmendur më lart, sipërmarrësit e prekur nga këto rregulla kanë përgjegjesinë që të krijojnë sisteme dhe aftësi funksionale për të mundësuar pajtueshmëri të plotë me këto detyrime rregullatore. Megjithatë, është e rëndësishme që AKEP të mbajë komunikim dhe bashkëpunim të hapur me sipërmarrësit gjatë fazës së tranzicionit për të siguruar arritjen e rezultateve të dëshiruara dhe shmangien e harxhimit të panevojshëm i burimeve.

Një pamje përmbledhëse e planifikimit të tranzicionit është si më poshtë:

- Pas publikimit të dokumentit përfundimtar rregullator që përmban këto rregulla dhe udhëzime, Sipërmarrësit me FNT që kanë detyrime në lidhje me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos do të kenë detyrim të paraqesin të gjitha raportet, pasqyrat dhe informacionin mbështetës të specifikuar për secilën periudhë kontabiliteti që mbaron më 31 Dhjetor. Periudha e parë për të cilën do raportohet do jetë viti që mbaron më 31 Dhjetor 2014. Raportet duhet të depozitohen në AKEP deri më 30 Qershor të cdo viti, duke filluar nga 30 Qershor 2015.
- Dispozitat për caktimin e audituesit të përmendura në Seksion 3 të këtij dokumenti do të zbatohen gjatë fazës së tranzicionit, që lejon kohë të mjaftueshme për të siguruar angazhimin me AKEP-në dhe një proces efektimi caktimi të audituesve.
- AKEP do të raportojë mbi çështjet e pajtueshmërisë në lidhje me sipërmarrjet e prekura brenda tre muajve nga dorëzimi i dokumentacionit, me përjashtim të rastit kur problemet e dala përfshijnë ndonjë kërkesë për ridorëzimin e dokumentacionit ose ndryshim të konsiderueshëm të raportimit dhe dokumentacionit.

7.3 Procesi periodik

Pasi të ketë përfunduar periudha e lartpërmendur e tranzicionit të Sipërmarrësit, të gjithë Sipërmarrësit do të kenë gjashtë muaj pas përfundimit të vitit financiar përkatës të kontabilitetit ligjor për të paraqitur të gjitha raportet dhe dokumentacionet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos.

AKEP-i do ta nxjerrë raportin e tij mbi pajtueshmërinë në lidhje me një Sipërmarrës brenda gjashtë muajve nga dorëzimi, në varësi të ndryshimeve në rast të një kërkesë për ridorëzim ose ndryshim thelbësor të raportimit dhe dokumentacionit.

AKEP-i ka të drejtën të rishikojë dhe ndryshojë rregullat dhe udhëzimet, të cilat mund të përfshijnë këshillimin me publikun, dhe si pasojë e kësaj të përcaktojë masat e duhura të tranzicionit që rezulton nga ndryshimet e kryera.

AKEP po ashtu ka të drejtën për të rishikuar dhe për t'u këshilluar mbi ndryshimet për vetë kërkesat e raportimit, nëse është e mundshme dhe e dëshirueshme që të shkurtojë afatin kohor për të rritur përfitimet e monitorimit rregullator dhe punën e analizuere të AKEP-it, mjedisin konkurrues në përgjithësi dhe mirëqenien e konsumatorëve Shqiptarë.

Një pjesë e rëndësishme e procesit rregullator të përgatitjes, dorëzimit dhe rishikimit të informacionit të ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos do të jenë komunikimet e hapura dhe të dobishme ndërmjet AKEP dhe industrisë, për të siguruar bashkëpunim dhe përmirësim në të ardhmen.

Shtojca 1 – Udhëzimet për Llogaritjen e Kostove

Pjesa kryesore e këtij dokumenti përmban përshkrime të metodologjive dhe parimeve të llogaritjes së kostove, veçanërisht në Pjesën 4. Kjo shtojcë ju jep udhëzime të hollësishme dhe specifike Sipërmarrësve me FNT mbi hapat që duhen ndjekur dhe teknikat që duhen përdorur në zhvillimin e sistemeve të llogaritjes së kostove që mund të sigurojnë pajtueshmëri me detyrimet e FNT në lidhje me ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos.

A1 Alokimi dhe atribuimi i kostove

A1.1 Procesi i alokimit të kostove

Ky Seksion përcakton procesin që duhet të ndjekin Sipërmarrësit me FNT për të alokuar kostot, kapitalin e punësuar dhe të ardhurat në ofrimin e llogarive të ndara dhe pajtueshmërisë me detyrimet rregullatore. Çdo përshkrim i procesit do të jetë i përgjithshëm dhe i mbështetur mbi praktikën më të mirë, megjithatë duhet kuptuar se çdo sistem i pajtueshëm i zhvilluar nga Sipërmarrësit në Shqipëri do të përputhet me procesin dhe metodologjinë që përmban ky dokument.

Figura 1 përshkruan një proces tipik të alokimit të kostove, konsistent me përshkrimet e dhëna në pjesën kryesore të këtij dokumenti. Proceset reale të alokimit mund të ndryshojnë në varësi të strukturës së saktë të një organizate, si dhe mënyrës sesi regjistrohen dhe paraqiten të dhënat brenda sistemeve financiare. Për këtë arsye, proceset e përdorura nga Sipërmarrësit me FNT mund të jenë më të ndërlikuara se sa ky shembull i përgjithshëm edhe pse ato duhet të jenë konsistente me të në parim, për të siguruar që AKEP të ketë besim që llogaritë rregullatore funksionojnë mirë, alokimi i kostove është transparent dhe konsistent me parimet e kontabilitetit rregullator dhe se dokumentacioni dhe supozimet janë gjithëpërfshirëse dhe të auditueshme.

Procesi fillon me të dhënat e grumbulluara dhe ruajtura në librin e përgjithshëm të llogarive ose në sisteme të tjera të kostove dhe financiare të përdorura nga një kompani. Niveli i detajeve në të cilat kostot regjistrohen fillimisht është me rëndësi të madhe për dobinë përfundimtare dhe saktësinë e informacionit të kostove. Sipërmarrësi duhet të zbatojë një nivel të lartë detajimi të diz-agreguar duke iu referuar shërbimeve përkatëse të ofruara prej tij. Informacioni i kostove duhet ndarë ndërmjet kostove operacionale, kostove kapitale dhe hyrjeve të kontabilitetit si për shembull amortizimi.

Kostot mund t'i atribuohen drejtpërdrejtë shërbimeve ose mund të alokohen midis qendrave të kostove për analiza të mëtejshme, të cilat do të përcaktohen nga funksioni ose qëllimi.

Shërbimet

Kostot që mund të identifikohen direkt me një shërbim të veçantë duhen caktuar direkt tek ai shërbim. Shërbimi mund të jetë me pakicë, si për shembull një minutë thirrje dalëse, ose me shumicë, si për shembull një njësi e terminimit të thirrjes.

Elementët e rrjetit

Kjo është një qendër kostosh që përmban kostot që kanë të bëjnë me transmetimin, komutimin dhe teknologjinë dhe sisteme të tjera të rrjetit. Këto kosto nuk mund të caktohen direkt te shërbimet sepse janë shkaktuar në ofrimin e një numri shërbimesh.

Funksionet e lidhura

Kjo është një qendër kostosh që përmban kostot e funksioneve të nevojshme për të ofruar shërbimet të klientit të shitjes me pakicë dhe me shumicë, të tilla si faturimet, mirëmbajtja dhe shërbimi ndaj klientit.

Funksionet e tjera

Kjo është një qendër kostosh që përmban kostot e funksioneve që nuk kanë lidhje me ofrimin e shërbimeve të veçanta, por që janë pjesë e operacioneve të një kompanie. Këto do të përfshijnë funksionet e mbështetjes të tilla si planifikimi, burimet njerëzore, financa dhe administrimi i përgjithshëm.

Sipërmarrësit me FNT duhet të përdorin një metodologji të kostove mbështetur në aktivitetet⁸ (ABC) për të alokuar kostot nëpërmjet këtij procesi, duke derivuar shtytësit e kostove dhe qendrat e kostove që sigurojnë zbatimin e parimit të shkaktimit të kostos dhe një proces konsistent me këtë të përshkruar këtu.

Alokimi i të gjitha kostove tek shërbimet do të kryhet nëpërmjet një numri hapash në një metodë përsëritëse. Hapat përfshijnë përdorimin e shtytësve të duhur të kostos dhe përcaktimin e qendrave të kostos për nën-alokim. Një pamje e përgjithshme e hapave që do të vijojnë është më poshtë:

- 1) Alokimi i kostove që kanë lidhje me funksionet e tjera (shiko më sipër) midis funksioneve të lidhura, elementëve të rrjetit dhe shërbimeve.
- 2) Alokimi i kostove të funksioneve të lidhura midis elementëve të rrjetit dhe shërbimeve.
- 3) Alokimi i elementëve të rrjetit midis shërbimeve.
- 4) Grupimi i shërbimeve në kategoritë të tjera të analizimit (segmentet e tregut, linjat e prodhimit, bizneset, etj.) për qëllime të raportimit të ndarjes së llogarive.

Kjo është një pamje e thjeshtuar e hapave që duhen ndërmarrë. Secili prej hapave ka të ngjarë të përfshijë një numër nën-hapash të detajuar, veçanërisht nëse informacioni i kostos është grumbulluar në formë të agreguar. Preferohet të përdoret një metodë alokimi që përfshin disa caktime direkte dhe indirekte në mënyrë të shkallëzuar, dhe jo nëpërmjet një hapi të vetëm arbitrar. Operacioni ekzakt i kryer për të realizuar alokimin dhe metodologjia e zbatuar do të jenë unike për secilin Sipërmarrës me FNT dhe është e rëndësishme të theksohet që dokumentacioni gjithëpërfshirës është një pjesë përbërëse e detyrimeve rregullatore, në mënyrë që proceset dhe të dhënat të jenë transparente për AKEP dhe detajet të jenë të disponueshme për palë të tjera kur nevojitet.

Sipërmarrësit me FNT do të duhet të përdorin teknikat e marrjes së mostrave dhe rishikimet veprimtarive që lidhen me to për të alokuar kostot dhe për t'u siguruar që shtytësit e kostos dhe përcaktimet e qendrës së kostove të jenë reale dhe të sakta. Ky aspekt ndër të tjera mund të përfshijë studim periodik të detyrave të personelit dhe kohës së punës, përdorimin e rrjetit dhe përdorimin e sistemeve. Rezultatet nga ky tip rishikimi do të futen te metodologjia dhe modelet e alokimit. Detajet e përkufizimeve dhe llogaritjeve që janë në bazën e procesit të alokimit të kostove duhen përfshirë në dokumentacionin rregullator të depozituar, së bashku me teknikat e anketimit dhe marrjes së mostrave dhe metodën e rishikimit. Kjo siguron që AKEP të mund të analizojë çdo çështje që ka të bëjë me metodologjinë me Sipërmarrësit, si dhe rrit kuptueshmërinë e AKEP mbi pasqyrat dhe pajtueshmërinë.

⁸ Në gjuhën angleze: Activity-Based Costing (ABC). (Shënim i përkthyesit)

A1.2 Shkaktimi i kostos

Analizimi i kostove dhe atribuimi i tyre të shërbimit është një detyrë e ndërlikuar, dhe detajet e tyre ndryshojnë ndërmjet rrjeteve dhe Sipërmarrësve. Alokimet duhen mbështetur mbi parimet e shkaktimit të kostos, transparencës, objektivitetit dhe qëndrueshmërisë.

Kostot dhe të ardhurat duhen alokuar direkt ose indirekt, të shërbimit që "shkaktojnë" këto kosto dhe gjenerojnë të ardhurat. Kjo krijon nevojën për metodologji të alokimit të kostove sikurse janë përcaktuar në këtë dokument dhe kërkon një proces ku një Sipërmarrës me FNT duhet të rishikojë dhe justifikojë kostot dhe të ardhurat, të përcaktojë një shtytës që shkakton krijimin e secilit zë, të përdorë shtytësin për të alokuar secilën kosto të shërbimit ose qendrat e kostove dhe të dokumentojë të gjitha proceset dhe teknikat e përdorura. Dokumentacioni i paraqitur si pjesë e dokumentacionit rregullator të depozituar duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të bëjë të mundur që AKEP të kuptojë dhe rishikojë shtytësit dhe qendrat e kostove.

Një sistem i koherent i alokimit të kostove bazuar në aktivitete do bëjë të mundur që Sipërmarrësi me FNT të krijojë një paketë të fortë të marrëdhënieve shkakësore ndërmjet kostove dhe shërbimeve, të cilat mund të përshkruhen në mënyrën e duhur për AKEP-in për qëllime të rishikimit rregullator të pajtueshmërisë. Fazat e ndërmjetme të futura nga një sistem ABC funksionues dhe i ndërlikuar në masën e duhur, bëjnë të mundur që kostot të cilat mund të caktohen në një mënyrë më arbitrare, t'i atribuohen shërbimeve që i shkaktojnë ato. Prandaj, kjo metodë mundëson alokimin e një proporcion më të lartë të kostove indirekte në mënyrë objektive të produktet/shërbimit që shkaktojnë rritjen e tyre. Edhe me ABC, disa kosto do të mbeten që të alokohen në një mënyrë më arbitrare dhe trajtimi i këtyre duhet dokumentuar qartë së bashku me detajet e metodologjisë dhe justifikimit. Kjo duhet të jetë Marzhi Proporcional i Barabartë (EPMU), ku kostot ndahen bazuar në të ardhurat ose në kostot e tjera që janë alokuar tashmë. Një sistem kostosh i zhvilluar siç duhet që pajtohet me udhëzimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë dokument duhet të minimizojë nivelin e kostos që ka nevojë të ndahet në këtë mënyrë. Sipërmarrësit me FNT duhet të përcaktojnë një nivel maksimal të synuar prej 10% të kostove të përgjithshme për këtë element, në mënyrë që çdo nivel më i madh se 10% duhet të shkaktojë një analizë dhe rishikim për të rritur detajet dhe efektshmërinë e modelit.

A1.3 Kostot operacionale

Këto udhëzime, së bashku me udhëzimet dhe parimet në dokumentin kryesor, duhen ndjekur nga Sipërmarrësit FNT, po nuk mund të ofrojnë çdo hollësi specifike të Sipërmarrësve individualë dhe sesi ata regjistrojnë dhe analizojë kostot. Secili Sipërmarrës pritet të zhvillojë sisteme në pajtueshmëri me këtë dokument, që optimizojnë dobishmërinë dhe saktësinë e rezultateve për çështjen specifike. Sa më poshtë jepet një pamje e kategorive të kostove operacionale dhe metodat e alokimit dhe atribuimit të cilat mund të përdoren për to.

Planifikimi dhe zhvillimi i rrjetit

Kostot (pagimet apo pagesat e tjera) duhen alokuar drejtpërdrejtë elementëve të rrjetit sa më shumë që të jetë e mundur.

Administrimi i rrjetit

Kostot duhen alokuar elementëve të rrjetit bazuar mbi kohën e harxhuar nga personeli (për listëpagesash) dhe mbështetur tek ajo se cili aspekt i rrjetit po administrohet (për kostot e tjera).

Furnizimi/instalimi i pajisjeve

Kostot i duhen alokuar drejtpërdrejtë elementëve të rrjetit ose bazuar mbi kohën e harxhuar nga personeli (për listëpagesash) dhe mbështetur tek ajo se cili aspekt i rrjetit po instalohet (për kostot e tjera).

Mirëmbajtja dhe riparimi

Kostot duhen alokuar drejtpërdrejtë elementëve të rrjetit kur është e mundur, për listëpagesën dhe kostot e tjera, përndryshe bazuar në kohën e harxhuar për mirëmbajtjen dhe riparimin (për listëpagesë).

Shërbimi ndaj klientit, marketingu dhe shitjet

Kostot e pagave i duhen alokuar drejtpërdrejtë shërbimeve, kur është e mundur, përndryshe duhen ndarë mbështetur në kohën e punës. Kostot e tjera, të cilat duhet të përfshijnë operacionet e qendrës së telefonatave (call centres), reklamës, promovimit, kërkimit të tregut, etj., po ashtu duhen alokuar drejtpërdrejtë sa më shumë që të jetë e mundur. Atribuimi të shërbimet përndryshe duhet bërë mbështetur mbi baza të aktivitetit të duhur për kostot dhe të lidhura me këto shërbime.

Faturimi dhe mbledhja e borxhit

Kostot e pagave i duhen alokuar drejtpërdrejtë shërbimeve, kur është e mundur, ose përndryshe duhen ndarë midis tyre në bazë të kohës së punës dhe matjeve të përdorimit, përfshirë vëllimet e faturave.

Shërbimet e Sipërmarrësit dhe të numërorit

Kostot e pagave dhe pagesave të tjera i duhen alokuar drejtpërdrejtë shërbimeve, kur është e mundur, ose përndryshe duhen ndarë midis tyre në bazë të kohës së punës dhe dhe matjeve të përdorimit, përfshirë vëllimet e faturave.

Pagesat te Sipërmarrësit e tjerë

Pagesat dalëse që kanë të bëjnë me trafikun dalës dhe pagesat për interkoneksionin duhen alokuar direkt tek shërbimet.

Kostot mbështetëse

Kostot e funksionimit të burimeve njerëzore i duhen alokuar grupeve të personelit brenda fushave të tjera të koston për alokim të mëtejshëm së bashku me këto kosto të personelit.

Kostot mbështetëse të zyrave qendrore (përfshirë financën, juridik, etj.) i duhen caktuar drejtpërdrejtë shërbimeve nëse është e mundur, ose përndryshe një qendre kostoje për alokim proporcional.

Kostot e ndërtesave i duhen alokuar direkt shërbimeve nëse është e mundur, ose përndryshe qendrave të duhura të kostove që kanë të bëjnë me përdorimin e rrjetit ose përdorime të tjera (të tilla si funksionet e zyrës qendrore) për alokim të mëtejshëm.

Kostot e kompjuterëve dhe të teknologjisë së informacionit i duhen alokuar aplikacioneve specifike kur është e mundur, në mënyrë që këto kosto të mund të atribuohen te shërbimet. Kostot e mbetura të teknologjisë së informacionit mund të alokohen te qendrat e kostove mbështetëse për alokim proporcional (për shembull, rrjete në ndërtesat e zyrave qendrore).

Amortizimi

Amortizimi duhet alokuar mbi të njëjtat baza si dhe alokimi i aktiveve fikse me të cilat është i lidhur.

A1.4 Kostot e kapitalit dhe kapitali i punësuar

Seksioni 4.2.3 më sipër përmban disa përshkrime se çfarë kërkohet të kryhet nga Sipërmarrësit me FNT për llogaritjen e kostos së kapitalit dhe kapitalit të punësuar, në përgatitjen e pasqyrave financiare rregullatore dhe dorëzimet të AKEP. Në rastet kur ka detyrime të orientimit në kosto në Shqipëri, ato përfshijnë detyrime për përllogaritje të tilla dhe çdo metodologji e përdorur në lidhje me detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos duhet të jetë konsistent me to. Rregullat për FNT i lejon Sipërmarrësit të përftojnë një fitim të arsyeshëm mbi investimin dhe për këtë arsye kjo duhet pasqyruar në sistemet dhe raportimin e llogaritjes së kostove.

Kostoja e kapitalit

Kostoja e kapitalit të një Sipërmarrësi me FNT duhet të pasqyrojë koston oportune të fondeve të investuara në elementët e rrjetit dhe aktivet përkatëse. Ajo duhet të përfshijë:

- koston mesatare të ponderuar të borxhit për formë të ndryshme të borxhit që mban Sipërmarrësi;
- koston e kapitalit të vet (të pronarëve) që del nga një vlerësim i rrezikut dhe fitimeve të kërkuara nga investitorët; dhe
- vlerat e borxhit dhe kapitalit të vet të kompanisë.

Informacioni i grumbulluar nga këto aspekte lejon bërjen e një llogaritjeje të Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC)

Formula që duhet përdorur nga Sipërmarrësit është si më poshtë

$$WACC = (E/E+D) \times (re/1-te) + (D/D+E) \times rd$$

Në këtë formulë:

E është vlera gjithsej e kapitalit të vet	rd është kostoja e borxhit
D është vlera gjithsej e borxhit	te është norma e taksës
re është kostoja e kapitalit të vet	

Ky variant i formulës jep vlerën e WACC para-tatimit, që nevojitet të përdoret në modelet e llogaritjes së kostove.

Modeli i Vlerësimit të Aktiveve Kapitale (CAPM) duhet të përdoret, kur është e mundur dhe për sa është e përshtatshme, për të nxjerrë koston e kapitalit të pronarëve për një Sipërmarrës me FNT. Kjo formulë është si më poshtë:

$$Re = Rf + (Be \times Pm)$$

Në këtë formulë:

Rf është norma e fitimit pa rrezik	Pm është primi i tregut
Be është rreziku i aktiveve të rregulluara në varësi të rrezikut të tregut (faktori beta i matur)	

Nëse CAPM nuk mund të përdoret, për arsye të miratuara nga AKEP-i, formula zëvendësuese do të jetë:

$$Rf + Pm.$$

AKEP duhet të konsiderojë të gjitha aspektet e llogaritjeve të bëra dhe transparenca e procesit është jashtëzakonisht e rëndësishme. Një përshkrim i çështjeve të ndryshme për AKEP-in që të vlerësojë lidhjen me elementet e llogaritjes WACC është si më poshtë:

- Kapitali i aksionerëve duhet matur si sasia mesatare e aksioneve në qarkullim në vitin në fjalë.
- Borxhi bruto duhet matur me vlerën kontabël dhe kostoja e borxhit të llogaritet si mesatare e ponderuar e kostove të ndryshme të borxhit në qarkullim.
- Primi i rrezikut të aktiveve të tregut, që është primi i pritur për të investuar në aktive të tregut në raport me investimet pa rrezik, dhe mund të matet nga historiku i ndryshimeve ndërmjet aksioneve dhe bonove. Kjo mund të nxirret nga tregu Shqiptar ose nga analizat krahasuese të tregjeve ndërkombëtare. AKEP-i do të japë udhëzime përfundimtare mbi këtë çështje gjatë fazës së zbatimit të këtyre detyrimeve.
- Norma pa rrezik duhet nxjerrë nga bonot qeveritare Shqiptare me një maturim dhjetë vjeçar.
- Faktorët beta duhen nxjerrë nga një analizë e treguesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe operacioneve të biznesit të grupeve multinacionale të lidhura me Sipërmarrësit FNT Shqiptarë, në mënyrë që të pasqyrohet në mënyrë të arsyeshme gjendja reale e Sipërmarrësve. Faktorët e propozuar duhen miratuar nga AKEP.
- Norma e taksës së përdorur në një llogaritje duhet të jetë niveli real i taksës së paguar nga një entitet gjatë vitit të zbatimit.

AKEP-it mund t'i duhet të shikojë nëse WACC i nxjerrë për një Sipërmarrës me FNT si një i tërë është i përshtatshëm për veprimtaritë e rregulluara të këtij Sipërmarrësi. Mund të jetë e nevojshme që rreziqe të ndryshme të zbatohen në veprimtari të ndryshme, të cilat mund të përfshijnë masa alternative të parametrave WACC për tregje të ndryshme ose veprimtari të paagreguara. Nevoja për këtë lloj llogaritjeje alternative, kur ekziston, duhet të identifikohet nga Sipërmarrësi FNT dhe të propozohet te AKEP përpara skadimit të afatit kohor për dorëziminë dokumenteve rregullatore. AKEP do të rishikojë të gjithë faktorët dhe llogaritjet për t'i dhënë udhëzime Sipërmarrësit dhe miratimin përfundimtar për WACC e përdorur për të prodhuar pasqyra financiare rregullatore.

Sipërmarrësit FNT duhet të jenë të përgatitur që të diskutojnë llogaritjet me AKEP si pjesë e procesit të zbatimit dhe tranzicionit për këtë rregull, si dhe të përfshijnë hollësi të plota mbi metodologjinë dhe llogaritjet në mbështetje të informacionit të paraqitur me dokumentacionin përfundimtar të dorëzuar.

WACC dhe vlera e kapitalit

WACC duhet zbatuar te një vlerë kapitali për rrjetin dhe aktivet e tjera për të përcaktuar fitimin që duhet rikuperuar nëpërmjet tarifave të rregulluara. Identifikimi i vlerave të borxhit dhe kapitalit për veprimtaritë përkatëse përbërëse të një Sipërmarrësi mund të jetë i vështirë, pasi vendimet financiare të korporatave ndikohen nga faktorë të ndryshëm, përfshi mjedisin ekonomik dhe planifikimin e taksave. Pozicionimi i borxhit të një njësie mund të mos ketë lidhje specifike me kërkesat e financimit të veprimtarive individuale, prandaj kërkohet një metodë tjetër për të përcaktuar vlerën e kapitalit, sikurse tregohet më poshtë:

$$\text{Fondet e aksionerëve (kapitali) + Borxhi} = \text{Aktivet neto minus borxhin}$$

Rezultati i kësaj llogaritje është i njëjtë sikurse edhe aktivet fikse + aktivet aktuale - kreditorët (përfashto borxhin) - provizionet.

Vlerat e kapitalit për veprimtaritë e rregulluara mund të arrihen duke ndarë aktivet neto ose kapitalin në përdorim, ku ndarja të bëhet mbështetur tek shkaku dhe të përdoren metodologjitë e vlerës aktuale.

Kapitali i punësuar

Sikurse u përmend në Seksionin 4.2.3 të dokumentit kryesor, kërkohet një llogaritje e kapitalit mesatar të punësuar për qëllime të llogaritjes së fitimeve të rregulluar. Për shkak se kapitali i punësuar në pika të vecuara në kohë, mund të mos jetë përfaqësues i kërkesave të kapitalit mesatar punësuar gjatë një periudhe afat-gjatë. Mesatarja duhet llogaritur ndërmjet fillimit dhe fundit të vitit në fjalë.

Pjesa më poshtë ofron një paraqitje të kategorive të kapitalit të punësuar dhe metoda të mundshme alokimi të tyre. Ajo ofron edhe një tregues të fushave të biznesit tek të cilat mund të alokohet një zë. Kjo nuk është një listë e plotë ose përfundimtare dhe secili Sipërmarrës me FNT duhet të zhvillojë analizat dhe justifikimet mbështetëse.

Pajisjet e komutimit

Si rregull, pajisjet e komutimit (lokal, tranzit, ndërkombëtar, etj.) duhen alokuar direkt te qendrat e kostove të elementëve të aksesit lokal ose të rrjetit kryesor kur është e mundur, përndryshe duhen ndarë mbështetur te përdorimi ose alokuar në një qendër të ndërmjetme kostoje për analiza të mëtejshme. Këto kosto kapitali kanë të ngjarë t'i përkasin njësive të biznesit të aksesit lokal ose rrjetit kryesor (celular ose fiks).

Pajisjet e transmetimit

Këto lloj pajisjesh duhen alokuar direkt te qendrat e kostos së elementëve të rrjetit, kur është e mundur, përndryshe duhen alokuar mbi baza të përdorimit. Analiza mundet që të ketë nevojë për faza të ndërmjetme për të kryer alokimin. Njësitë e biznesit në fjalë do të jenë rrjeti kryesor (akses lokal, fiks ose celular).

Aktive të tjera të rrjetit kryesore

Nëse një impiant dhe pajisje është përkushtuar te ofrimi i shërbimit, alokimi duhet të jetë direkt te shërbimi përkatës. Ndër të tjera kjo mund të mbulojë rrjetin inteligjent, pajisjet multimediale dhe në mjediset e klientëve. Atje ku aktivet shërbejnë për më shumë se një shërbim, ndarja duhet bërë mbi baza të matjeve të përdorimit, të cilat janë kryer siç duhet. Rrjeti dhe veprimtaritë e tjera të njësive të biznesit do të ndikohen nga ky alokim.

Impiantet ndihmëse

Tubacionet, pajisjet e energjisë dhe ajrit të kondicionuar si dhe pajisjet e rrjetit të administrimit në përgjithësi duhet të alokohen mbi bazën e mënyrës së përdorimit të tyre për t'i shërbyer impiantit dhe aktiveve kryesore të rrjetit. Ky impiant do t'i përkasë njësive të biznesit të rrjetit kryesore (akses lokal, fiks ose celular).

Aktive fikse jo të rrjetit

Toka dhe godinat duhen alokuar mbi baza të hapësirës që zënë shërbimet, elementët e rrjetit ose qendra të tjera të ndërmjetme të grupimit të kostove. Aktivet e tjera, përfshi kompjuterët, automjetet dhe pajisjet e zyrës, duhen alokuar në një mënyrë të ngjashme duke përdorur masat e përdorimit dhe aq hapa përsëritës sa kërkohet për të arritur alokimin. Ky alokim ndikon të gjitha njësitë e biznesit.

Aktive fikse të patrupëzuara

Nëse ekzistojnë, ato duhen alokuar direkt te shërbimet, kur është e mundur. Përndryshe, kjo kërkon një metodë, për të cilën duhet rënë dakord me AKEP për të siguruar qëndrueshmërinë dhe drejtësinë.

Kapitali punues

Ky do të përfshijë zërat si cash dhe investimet, aksione, debitorët dhe kreditorët dhe provizionet për detyrimet. Si rregull, zërat duhen alokuar direkt te produktet dhe shërbimet sa herë të jetë e mundur. Përndryshe, metodat për caktimin mund të përfshijnë masat e veprimtarive përkatëse ose alokimin te qendra të tjera kostosh sikurse të jetë e përshtatshme. Çdo atribuum arbitrar ose probleme me alokimin duhen diskutuar dhe miratuar nga AKEP më parë.

A1.5 Pagesat per transferimet

Sipërmarrësit me FNT duhet të përcaktojnë një sistem për transferimet ndërmjet njësive ose ndarjeve brenda biznesit të tyre, për shembull pagesat për shërbimin nga rrjeti kryesor te biznesi i shitjes me pakicë. Kjo do të përfshijë llogaritjen e kostove dhe të ardhurave nga ofrimi i brendshëm i shërbimit.

Për qëllime të ndarjes së llogarive që është përshkruar në Seksion 4.4 të dokumentit kryesor, duhet supozuar se një klient i brendshëm i Sipërmarrësit me FNT paguan të njëjtën pagesë për të njëjtin shërbim sikurse paguhet nga klientët e jashtëm me shumicë.

Llogaritja e transferimeve duhet të ndjekë metodën e përcaktuar më poshtë:

- Transferimet (të ardhurat dhe kostot) i duhen atribuar përbërësve të kostos, shërbimeve dhe njësive të paagreguara të biznesit në përputhje me veprimtaritë që kanë gjeneruar të ardhurat ose që kanë shkaktuar kostot.
- Atribuimi duhet të jetë objektiv dhe duhet të ndjekë parimet e paraqitura në Seksion 3.2 të dokumentit kryesor pa përfutur asnjë biznes ose ndarje e paagreguar.
- Nga viti në vit duhet të ketë qëndrueshmëri në trajtimin e transferimeve.
- Metodat e përdorura për transferimet duhet të jenë transparente dhe të mbështetura nga një arsyetim i qartë.
- Pagesat për transferimet për veprimet e brendshme duhen mbështetur mbi përdorimin dhe pagesat për njësi.
- Pagesat për transaksionet e brendshme duhet të jenë të barasvlershme me pagesat për të njëjtin shërbim të shitur jashtë. Njësitë ose departamentet e brendshme duhen të paguajnë të njëjtën pagesë interkoneksioni dhe aksesit sikurse paguajnë klientët e jashtëm me shumicë sipas kushteve të çdo oferte referencë përkatëse dhe marrëveshje interkoneksioni.
- Llogaritë e ndara duhet të paraqesin transferimet ndërmjet bizneseve ose seksioneve të paagreguara.

A1.6 Të ardhurat

Të ardhurat nga shërbimet fikse dhe celulare të shërbimeve të telekomunikacioneve duhen alokuar drejtpërdrejtë te produktet dhe shërbimet me të cilat kanë lidhje mbi baza të të dhënave të kontabilitetit dhe informacionit të faturimit. Në rastet kur ky alokim direkt nuk është i mundur, të ardhurat duhen atribuar mbi bazat e shkakut që i krijoi këto të ardhura.


Të ardhurat do të alokohen ndërmjet njësive përkatëse të biznesit të Sipërmarrësit me FNT, të tilla si rrjeti i aksesit lokal, rrjeti kryesor dhe i shitjes me pakicë. Të ardhurat nga tregu me pakicë do të përfshijnë shërbime të tilla si pagesat e telefonatave, mesazhet, lidhja në rrjet dhe pagesa mujore e linjave, shërbimet e të dhënave broadband dhe linjat me qira. Të ardhurat nga shitjet me shumicë do të përfshijnë shërbimet që kanë të bëjnë me rrjetin e aksesit dhe rrjetin

kryesor, të tilla si origjinimi dhe terminimi i telefonatës, tranziti dhe interkoneksioni, shërbimet e shitjes me shumicë të broadband dhe hapja e qarkut lokal(LLU).

Të ardhurat nga veprimtari të tjera, të cilat mund të përfshijnë dhënie me qira dhe shitjen e pajisjeve, shërbimet e reklamimit dhe ato inxhinjerike duhen alokuar dhe raportuar brenda llogarive të paagreguara në përputhje me parimet e ndarjes dhe shkakut.

Sipërmarrësit me FNT mund të krijojnë të ardhura nga shërbimet që nuk janë telefonike ose nuk janë të komunikimeve elektronike. Këto të ardhura duhen alokuar te veprimtaritë me të cilat kanë lidhje dhe trajtimi i të ardhurave jo kryesore duhet të jetë transparent dhe i qëndrueshëm për të siguruar që fitimet e seksioneve të ndara të deklarohen me saktësi.

A1 Figura 1 ProceS Tipik i Alokimit të Kostove



A2 Vlerësimi i aktiveve

Pjesa 4.2 e dokumentit kryesor përmban përshkrimet e metodologjive të llogaritjes aktuale të kostos dhe ruajtjes së kapitalit. Kjo pjesë e Shtojcës i referohet hollësive të njëjta dhe jep udhëzime të qarta të cilat mund të ndiqen nga Sipërmarrësit me FNT.

A2.1 Llogaritja e kostos aktuale

Sipërmarrësit me FNT duhet të ndjekin një metodologji të llogaritjes së kostos aktuale (CCA) për të përgatitur pasqyrat financiare rregullore të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostove. Metoda kryesore për të llogaritur koston aktuale të një aktivi duhet të jetë që të llogaritet vlera e hequr (vlera e firmës) sikurse është përcaktuar në hapat e treguar më poshtë:

- 1) Llogarisni vlerën neto të realizueshme të aktivitetit, që është vlera e shitjes së tij minus kostot e shitjes me çmime aktuale.
- 2) Llogarisni vlerën ekonomike të aktiveve, që është vlera neto aktuale e rrjedhës së ardhme të parasë që pritet përgjatë jetëgjatësisë së mbetur të aktivitetit.
- 3) Nxirrni një shumë të rikuperueshme teorike për aktivitetin, që është më e larta prej dy vlerave të përshkruara më lartë.
- 4) Nxirrni vlerën e mbetur të aktivitetit, që është vlera më e ulët midis shumës së rikuperueshme dhe kostos neto të zëvendësimit të aktivitetit (kostoja aktuale e një aktivi tjetër me karakteristika dhe moshë të ngjashme).

Sipas kësaj metodologjie, vlera e hequr është kostoja reale e aktives.

Kostoja bruto e zëvendësimit

Kostoja bruto e zëvendësimit llogaritet të jetë e afërt me vlerën e një rrjeti të ri që ofron në të njëjtin nivel funksionaliteti dhe kapaciteti sikurse dhe ai ekzistues. Kjo vlerë mund të nxirret duke përdorur vlerat reale të tregut, treguesin e kostos historike ose vlerësimin e aktiveve ekuivalente moderne. Për shkak se kjo metodologji mund të mos prodhojë një vlerë të përshtatshme të aktivitetit për matjen e performancës financiare, nuk duhet përdorur si mjete parësor për të llogaritur koston aktuale.

Mund të ketë raste ku llogaritja e vlerës së hequr është e papërshtatshme, jashtë mase e ndërlikuar ose e pamundur. Në raste të tilla, Sipërmarrësit me FNT duhet të përcaktojnë vlerat e kostos aktuale të aktivitetit duke identifikuar koston bruto të zëvendësimit, duke përdorur teknikat më të përshtatshme dhe informacionin në dispozicion. Të gjitha supozimet dhe të dhënat duhet të jenë transparente në informacionin që mbështet pasqyrat financiare rregullore dhe në gjendje për t'u rishikuar me hollësi nga AKEP-i.

Atje ku pajisjet ekzistuese nuk mund të zëvendësohen në të njëjtën formë për shkak të ndryshimit të teknologjisë, për vlerësimin e kostos aktuale duhet ndjekur metoda e aktiveve moderne ekuivalente. Atje ku teknologjitë e reja kanë përmirësuar ndjeshëm funksionalitetin dhe efikasitetin, duhen bërë përshtatje të vlerat e pajisjes për të pasqyruar koston e një aktivi me karakteristika dhe aftësi të ngjashme. Këto përshtatje mund të përfshijnë kostot operacionale, funksionalitetin teknik dhe kapacitetin operacionale. Informacioni dhe supozimet e përdorura për të zgjedhur aktivitetet ekuivalente moderne duhet të jenë rrënjësisht të dokumentuara, së bashku me gjithë publikimin e hapave të llogaritjes që janë ndjekur.

A2.2 Ruajtja e kapitalit

Parimi i Ruajtjes Financiare të Kapitalit (FCM) (shiko Seksion 4.2.2 në dokumentin kryesor) duhet ndjekur nga Sipërmarrësit me FNT për qëllimin e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos. Kjo përcakton mënyrën sesi trajtohet kapitali i kompanisë kur vlerësohet fitueshmëria.

FCM konsideron që kapitali financiar i kompanisë ruhet me çmimin aktual. Të ardhurat bëhen fitime pasi një sasi e mjaftueshme është ofruar për të ruajtur vlerën financiare të biznesit.

Rivlerësimi i aktiveve duhet kryer në mënyrë konsistente me udhëzimet e dhëna më sipër dhe kjo do të prodhojë bazat për pagesa shtesë të amortizimit për të përshtatur pagesat të llogaria e fitimit dhe humbjes. Fitimet e mbajtura që dalin si rezultat i rivlerësimit me CCA çohen të llogaria e fitimit dhe e humbjes.

A2.3 Udhëzime të tjera për vlerësimin e aktiveve

Aktivet në proces duhet të mos amortizohen, por vlera e tyre duhet të pasqyrohet në kontabilitetin rregullator.

Aktivet që janë në qira financiare duhet të kapitalizohen dhe amortizohen dhe pagesat e interesit duhen përfshirë në kostot e financimit të aktivitetit, së bashku me çdo pagesë shoqëruese.

Aktivet plotësisht të amortizuara nuk duhen rivlerësuar kur përdoret CCA, për shkak se vlera kontabël e tyre e barabartë me zero është e pasqyruar krejtësisht në pasqyrat kontab.

Më poshtë është dhënë një ilustrim i kategorive të aktiveve dhe periudhat e amortizimit që është i dobshëm për këtë rast.

	Kategoria e aktivit	Periudhë ilustrative për amortizimin	Karakteristikat e aktivitetit/shembuj
A	E pakufizuar	N/A	Disa kategori aktivesh (si p.sh. toka) mund të mos 'konsumohen' gjatë ofrimit të shërbimeve ose nuk shfaqin reduktime sistematike të vlerës për shkak të përdorimit të tyre dhe si rrjedhojë mund të mos jenë objekt amortizimi.
B	Shumë e gjatë	40-80 vite	Punë të mëdha civile (si p.sh. tubacione) mund të kenë jetë ekonomike shumë të gjatë.
C	E gjatë	20-40 vite	Aktivet e përgjithshme që pritet të kenë një jetëgjatësi të kufizuar ekonomike, por për shkak të kohës së gjatë të aktiveve kjo mund të jetë e vështirë për tu përcaktuar me saktësi. Programet e zëvendësimit mund të japin të dhëna në lidhje me profiling e përdorimit actual (të tilla si linjat fundore të bakrit).

D	Mesatare	5-15 vite	Jeta ekonomike e aktivitet në këtë kategori normalisht është më e lehtë për t'u vlerësuar. Pajisjet e rënda mund të përfshihen në këtë kategori.
E	E shkurtër	2-5 vite	Shpesh e aplikuar për teknologjitë e kompjuterave, ku progresi është shumë i shpejtë dhe zëvendësimi i tyre është i nevojshëm për të ruajtur funksionalitetin.

Ky shembull është marrë nga dokumneti për konsultim publik i IRG mbi metodologjitë CCA (IRG (05) 40) rev1.

A3 Modelimi LRIC

Seksioni 4.3 i dokumentit kryesor përmban një përshkrim të metodologjive LRIC dhe aspekteve praktike të zbatimit të modelimit LRIC. Modelimi LRIC nga poshtë-lart është përdorur nga AKEP në Shqipëri për të përcaktuar tarifat e terminimit të thirrjeve, të cilat i nënshtrohen rregullave ekzistuese të kontrollit të tarifave (Vendimi 1505, Shkurt 2011 dhe vendimet shoqëruese rregullatore). Kjo metodë e nxjerrjes së kostove për njësi përdoret zakonisht nga rregullatorët për të llogaritur ato që konsiderohen të jenë çmime optimale, por për të përcaktuar detyrimet e Sipërmarrësve me FNT në lidhje me përgatitjen e modeleve të tyre të kostos dhe për t'i përdorur ato në përputhje me rregullat për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos ka nevojë për konsiderata të tjera. Llogaritja e kostos mbështet ndarjen e llogarive dhe detyrimet e orientimit në kosto, dhe udhëzimet e hollësishme të dhëna në pjesët e mëparshme të kësaj Shtojce i referohen metodologjisë së modelimit të kostove plotësisht të alokuara (FAC) që Sipërmarrësit me FNT do të duhet të zhvillojnë për të siguruar raportim financiar rregullator të pajtueshëm me rregullat. Një model efektiv LRIC duhet që po ashtu të zhvillohet për të ecur së bashku me sistemin e ndarjes së llogarive. Kjo pjesë e Shtojcës sqaron detyrimet e sakta të Sipërmarrësve të prekur në lidhje me modelimin LRIC.

A3.1 Karakteristikat e modelit LRIC

Sipërmarrësve FNT u kërkohet të zhvillojnë një model kostojë LRIC mbështetur në metodën nga lart-poshtë, që përdor të dhënat financiare të kompanisë si një pikë nisje dhe duhet të mundësojë rakordim të thjeshtë ndërmjet sistemeve të llogaritjes së kostos. Ky model mund të funksionojë me një sistem financiar ose veçmas si një aplikacion i vetëm. Modeli duhet të jetë në gjendje të prodhojë kosto për njësi mbështetur mbi një metodologji LRIC të pastër (duke përjashtuar mbulimin e çfarëdo lloj kostove të përbashkëta) si dhe kostot mbështetur në metodologjinë tradicionale LRIC, përfshirë mbulimin e kostove të përbashkëta mbi një bazë marzhi proporcional të barabartë (EPMU).

Për përcaktimin e kostove të shërbimeve duke përdorur një model lart-poshtë, duhet të ndiqen disa parime dhe karakteristika:

- Kostot përkatëse që kanë të bëjnë me operacionet, kapitalin punues dhe aktivet fikse duhen grupuar së bashku në kategori homogjene të kostove. Këto kategori, të cilat kanë ngjashmëri me qendrat e kostove në një sistem tradicional ABC, do të përmbajnë kosto

me të njëjtat karakteristika dhe për këtë arsye do të mundësojnë kryerjen e analizave të tjera si një grup duke përdorur një teknikë të vetme.

- Faktorët e Marrëdhënieve Kosto-Vëllim (CVR) duhet të nxirren për përdorim në alokimin e kostove ndërmjet elementëve të rrjetit, si dhe për atribuimin e disa kostove operacionale ndërmjet kategorive homogjene të kostove.
- Elementët e rrjetit duhen përcaktuar në mënyrë që të jenë konsistente me strukturën teknologjike të rrjetit dhe në mënyrë optimale për qëllime të llogaritjes së kostos, duke lejuar kështu gjurmimin e drejtpërdrejtë deri tek niveli i shërbimit.
- Kostot e elementëve të rrjetit duhen alokuar te shërbimet (produkti ose inkrementi përkatës rregullatore i përcaktuar nga detyrimet e FNT) duke përdorur faktorët e rrugëzimit, të cilët janë mbi baza të veprimtarisë ose konsumit për elementët individualë.

Kjo metodologji e llogaritjes së kostos do të prodhojë vlera LRIC për komponentët e rrjetit, që më pas përdoren për të prodhuar vlera LRIC për shërbimet individuale. Rezultatet përfundimtare nga modeli do të mund të krahasohen me kostot për njësi të FAC dhe me njësinë ose kostot e inkrementit të sunuar nga vendimet rregullatore. Modeli duhet po ashtu të jetë plotësisht i rakordueshëm me modelin e kostos FAC si dhe me pasqyrat financiare rregullatore dhe ligjore.

Sikurse është thënë, modeli LRIC duhet të bazohet në të dhënat financiare aktuale nga sistemet e kompanisë. Duhet të ketë konsistencë edhe në të dhënat për parametrat që kanë të bëjnë me CVR dhe faktorët e rrugëzimit, në mënyrë që modeli të mbështetet mbi variabla input përkatës dhe aktuale. Të gjitha modelet LRIC varen në masë të madhe nga parashikimi dhe projeksionet dhe sipërmarrësit me FNT duhet të jenë në gjendje të prodhojnë dokumentacion dhe justifikim të plotë në lidhje me çdo supozim mbi veprimtarinë, projektimin dhe kapacitetin e rrjetit si edhe eficensën.

A3.2 Kategoritë dhe analiza e kostos

Hapi i parë për të krijuar modelin LRIC është që të përcaktohen llojet e kostos, që pastaj të mund të grupohen në kategori homogjene kostosh. Llojet e kostove përfshijnë kostot e kapitalit (kapitali i punësuar dhe amortizimi, etj) dhe kostot operacionale. Trajtimi i këtyre brenda sistemit dhe në derivimin e modelit duhet të jetë konsistent me Seksionin A1 më sipër.

Grupimet e kategorive të kostove homogjene duhet të jenë të identifikueshme si të tilla, mbështetur në një analizë të shtytësve unikë të kostos, CVR, tendencave të çmimeve ose karakteristikave të tjera dalluese. Llojet e shpenzimeve me shtytës kostoje, CVR ose karakteristikat e tendencës së çmimit të ndryshme midis tyre nuk mund të grupohen në kategori të njëjta kostosh homogjene.

Supozimet që kanë të bëjnë me topologjinë e rrjetit janë diskutuar në Seksionin 4.3 të dokumentit kryesor. Sipërmarrësit me FNT duhet të përdorin metodën e "nyjës së djegur" të projektimit të rrjetit për modelimin LRIC. Kjo lejon që modeli të pasqyrojë rrjetet ekzistuese dhe një marrëdhënie më direkte me të dhënat mbi të cilat është mbështetur modeli. Supozimet mbi kapacitetin, eficensën dhe zhvillimet teknike duhet të jenë transparente, të justifikueshme dhe plotësisht të dokumentuara.

Sipërmarrësit me FNT duhet të nxjerrin CVR-t për gjithë kategoritë e kostove homogjene, mbështetur në një kombinim të modeleve inxhinjerie, analizave statistikore, studime të punës, intervistave dhe studimeve të llojeve të tjera sipas nevojës. CVR-t duhet që normalisht të pasqyrojnë pasojat e fuqisë blerëse të ekonomive të shkallës. Hollësitë e supozimeve dhe

Ilogaritjeve në lidhje me CVR-t duhen dokumentuar dhe duhet të jenë në dispozicion për inspektim nga AKEP për të mbështetur pasqyrat financiare rregullatore të dorëzuara.

Trafiku i rrjetit dhe të dhënat e veprimtarisë duhet të jenë qartësisht konsistente me statistikën e vitit aktual së bashku me të paktën të dhënat e parashikuara për dy vitet e ardhme. Kjo bëhet që llogaritjet për CVR-t, që përfshijnë supozime mbi nivelet e veprimtarisë dhe efikasitetin, të jenë të duhurat dhe të justifikueshme. Komponentët e përcaktuar të rrjetit duhet të jenë konsistent me praktikën më të mirë aktuale në BE dhe karakteristikat e përgjithshme të rrjetit, në mënyrë që të pasqyrojnë pamjen e parashikuar të kërkuar. Në mënyrë të ngjashme, faktorët e rrugëzimit duhen mbështetur mbi analizën e veprimtarisë aktuale dhe në të dhënat e parashikuara për të paktën dy vitet e ardhme, si dhe të pasqyrojnë teknologjinë dhe funksionin e rrjetit siç ekziston aktualisht.

Atje ku metoda EPMU përdoret për të alokuar kostot e përbashkëta dhe të bashkuara, ajo duhet zbatuar te kategoritë e kostos homogjene dhe duhet dokumentuar plotësisht për të mundësuar auditimin dhe kontrollin rregullator të pajtueshmërisë. Kjo pamje duhet të jetë në përputhje me versionin e pastër të modelit LRIC në një mënyrë që provon përjashtimin e kostove të përbashkëta nga ky i fundit.

A4 Udhëzime të tjera për ndarjen e llogarive

A4.1 Ndarja e llogarive dhe koha e ditës

Çmimet e shitjes me pakicë të disa shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë tendencën të ndryshojnë në vartësi të kohës së ditës ose ditës së javës. Variacionet janë zakonisht të lidhura me kapacitetin dhe faktorët e përdorimit ose janë krijuar për të nxitur përdorimin e rrjetit gjatë orëve më pak aktive të ditës. Atje ku pagesat për shërbimet me shumicë të rregulluara kërkohej të pasqyrojnë strukturat e kohës së ditës së pagesave (tarifave) me pakicë, vlerat mesatare të ponderuara të pagesave (tarifave) të orientuara në kosto duhet të jenë të njëjta sikurse dhe kostot e njësisive të lidhura me to.

A4.2 Modelet e kostos

Sipërmarrësve me FNT në Shqipëri që ju kërkohet nga ligji të zbatojnë këto rregulla të ndarjes së llogarive dhe llogaritjes së kostove, duhet t'i lejojnë AKEP-it mundësitë e aksesit të plotë në modelet e kostos në selitë e Sipërmarrësve, në mënyrë të tillë dhe me duke përfshirë hollësitë specifike, që AKEP-i të ketë mundësi të vlerësojë përshtatshmërinë dhe pajtueshmërinë e modeleve me rregullat. Sipërmarrësit me FNT duhet që po ashtu t'i japin AKEP-it dhe çdo pale të tretë të nominuar nga AKEP-i akses në burimet e të dhënave të modelit, brenda kufijve të arsyeshëm dhe kërkesave të AKEP-it gjatë cdo procesi rishikimi ose hetimi.

Sipërmarrësit me FNT duhet të krijojnë modele që janë të aftë për të kryer analiza të ndryshme dhe të skenarëve, në mënyrë që të mund të hetohet efekti i faktorëve të ndryshëm mbi rezultatet finale duke përdorur funksionalitetin e modelit. Shembuj të këtyre faktorëve (nuk është një listë e plotë) janë përfshirë më poshtë:

- Çmimet e pajisjeve
- Kapaciteti i rrjetit
- Përdorimi i pajisjeve
- Vëllimet e trafikut
- Kostoja e kapitalit
- Metodologjia e amortizimit

- Jeta e aktiveve dhe politika e kontabilitetit
- Tendencat e çmimit

A4.3 Dokumentacioni i modelit të kostos

Përshkrimi i modelit të kostos është pjesë e dokumentacionit të kërkuar me këto rregulla dhe udhëzime të përmendura në Seksionin 3.4. dhe 6 të dokumentit kryesor. Dokumentacioni duhet të përfshijë një listë të kategorive të kostos homogjene, shtytësve të kostos për secilën kategori dhe një listë të elementëve të rrjetit dhe aktiviteteve të tjera si faturimi, marketingu, burimet njerëzore, etj.

Dokumentacioni i metodologjive të alokimit duhet të përmbajë një përshkrim të shërbimeve të ofruara nga Sipërmarrësi me FNT brenda tregjeve përkatëse, si dhe detaje të plota të metodave të alokimit të kostove që kanë të bëjnë me funksionet e veprimtaritë e tjera dhe elementët e rrjetit, për modelet FAC dhe LRIC.

Për secilën kategori kostoje homogjene, dokumentacioni duhet të përfshijë:

- emrin e saj
- llojin e kostove që ajo përmban
- nëse është e varur apo e pavarur dhe
- detajet e CVR që janë të lidhura me të.

Për secilën Marrëdhënie Kosto-Vëllim duhet të ketë dokumentacion të detajuar që ka të bëjë me:

- nxitësin e kostos
- natyrën e CVR ("kurba" siç është ndërtuar në formatin e grafikut)
- vlerat e kostove fikse dhe të përbashkëta, dhe
- nëse është e varur apo e pavarur

A4.4 Auditimi i modelit të kostos

Modelet e kostos të ndërtuara nga Sipërmarrësit duhet të auditohen sipas dispozitave që janë përfshirë në Seksionet 3 dhe 4 të dokumentit kryesor, si pjesë e auditimit të pasqyrave financiare rregullatore.

Auditimet e modelit të kostos duhet të përmbajnë elementët e mëposhtëm:

- Objektin e kostove të përfshira brenda modelit
- Objektin e kostove të alokuara te shërbimet e veçanta të rregulluara
- Rregullimet ndërmjet të dhënave në model dhe në pasqyrat financiare ligjore.
- Saktësia e shumave të regjistruara për të dhënat operationale, vëllimet e trafikut, vëllimet e shërbimit dhe statistikat teknike përkatëse.
- Metodologjitë në lidhje me amortizimin, kapitalizimin, vlerësimin e aktiveve dhe alokimin e kostove
- Ndrejtjet ndërmjet modeleve të kostos dhe raportimeve të tjera të ndara
- Llogaritjet CVR dhe përshkrimet e kurbave të kostos
- Çdo informacion tjetër përkatës për të kuptuar modelin e kostos

Shtojca 2 Raporte shembuj

Kjo Shtojcë përmban disa modele dhe formate të sugjeruara raportimi, së bashku me formulime fjalësh, e që të gjitha mund të përdoren si baza për një Sipërmarrës që të përgatisë një set raportesh financiare të rregulluara dhe pasqyrat shoqëruese. Këta shembuj nuk synojnë të jenë përfundimtarë ose specifikë për një Sipërmarrës ose sektor tregu. Në të kundërt ato duhen përdorur si udhëzues, së bashku me rregullat dhe udhëzimet e shkruara në gjithë këtë dokument, për të ndihmuar në përgatitjen e dokumnetacionit rregullator të dorëzuar.

A2 Pasqyrat Kryesore Financiare

A2.1.1 Fitimi dhe humbja (pamja e tregut) – Telefonia Fikse

		Viti aktual	Viti i mëparshëm
Të ardhurat			
1	Me pakicë–Qira e linjës/mirëmbajtje		
	Me pakicë - Instalimi		
	Me pakicë–Thirrjet brenda rrjetit		
	Me pakicë – Thirrjet kombëtare		
	Me pakicë –Thirrjet ndërkombëtare		
	Me pakicë – Linjat me qira		
	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
2	Origjinimi i thirrjeve në tregun me shumicë (fikse)		
3	Terminimi i thirrjeve në tregun me shumicë (fikse)		
4	Aksesi lokal në tregun me shumicë		
5	Aksesi broadband në tregun me shumicë		
6	Linjat me qira në tregun me shumicë		
6	Tregu me shumicë - Transit		
7	Tranzitim me shumicë		
8	Të tjera (Zgjero sipas nevojave)		
Të ardhurat totale			
Kostot e operimit			
	Puna		
	Teknologjia e informacionit (TI) dhe sistemet		
	Mirëmbajtja dhe riparimi		
	Shitje dhe marketing		
	Financa dhe faturimi		
	Borxhi i keq		
	Administrimi i përgjithshëm		
	Financimi		
	Kosto të tjera		
	Amortizimi		
Kostot operacionale gjithsej			
Fitimi (HCA)			
Korrektimi CCA			
	Fitimi dhe humbja		

	Amortizimi shtesë		
	Të tjera		
Fitimi (CCA)			
Fitimi mbi kapitalin e punësuar			

Shënim: Shikoni A2.3 për vlerat e kapitali mesatar të punësuar

A2.1.2 Fitimi dhe humbja (pamja e tregut) – Telefonia Celulare

		Viti	Viti
		aktual	i mëparshëm
Të ardhurat			
1	Tregu me pakicë - Telefonatat brenda grupeve të mbyllura		
	Tregu me pakicë - Telefonatat brenda rrjetit		
	Tregu me pakicë - Telefonatat kombëtare		
	Tregu me pakicë - Telefonatat roaming		
	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
2	Terminimi i thirrjeve celulare kombëtare		
	Terminimi i thirrjeve celulare ndërkombëtare		
3	Terminimi i SMS-ve celular		
4	Të dhëna (data)		
5	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
Totali i të ardhurave			
Kostot e operimit			
	Puna		
	Teknologjia e informacionit dhe sistemet		
	Mirëmbajtja dhe riparimi		
	Shitjet dhe marketingu		
	Financa dhe faturimi		
	Borxhi i keq		
	Administrimi i përgjithshëm		
	Financimi		
	Kosto të tjera		
	Amortizimi		
Kostot operuese totale			

Fitimi (HCA)			
Korrektimet CCA			
	Fitimi dhe humbja		
	Amortizimi shtesë		
	Tjetër		
Fitimi (CCA)			
Fitimi mbi kapitalin e punësuar			

Shënim: Shikoni A2.3 për vlerat e kapitalit mesatar të punësuar

A2.2.1 Të ardhurat dhe shpenzimet (Pamja e brendshme/jashtme) – Telefonia Fikse

		Viti aktual	Viti i mëparshëm
Të ardhurat			
Të ardhurat e brendshme			
2	Origjinimi i thirrjeve në tregun me shumicë (fikse)		
3	Terminimi i thirrjeve në tregun me shumicë(fikse)		
4	Aksesi lokal në tregun me shumicë		
5	Aksesi broadband me shumicë		
6	Linjat me qira me shumicë		
7	Tregu me shumicë - Transit		
8	Të tjera (Zgjero sipas nevojave)		
Të ardhurat e jashtme			
1	Me pakicë–Qira e linjës/mirëmbajtje		
	Me pakicë - Instalimi		
	Me pakicë–Thirrjet brenda rrjetit		
	Me pakicë – Thirrjet kombëtare		
	Me pakicë –Thirrjet ndërkombëtare		
	Me pakicë – Linjat me qira		
	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
2	Origjinimi i thirrjeve në tregun me shumicë (fikse)		
3	Terminimi i thirrjeve në tregun me shumicë (fikse)		
4	Aksesi lokal në tregun me shumicë		
5	Aksesi broadband në tregun me shumicë		
6	Linjat me qira në tregun me shumicë		
7	Tregu me shumicë - Transit		
8	Të tjera (Zgjero sipas nevojave)		
Të ardhurat gjithsej			
Kosto operacionale (si në A2.2)			
Fitimi (HCA)			
Korrektimet CCA (si në A2.2)			
Fitimi (CCA)			

Fitimi mbi kapitalin e punësuar		
---------------------------------	--	--

Shënim Shikoni A2.3 për vlerat e kapitali mesatar të punësuar

A2.2.2 Fitimi dhe humbja (Pamja e brendshme/jashtme) – Telefonia Celulare

		Viti aktual	Viti i mëparshëm
Të ardhurat			
Të ardhurat e brendshme			
2	Terminimi i thirrjeve celulare kombëtare		
	Terminimi i thirrjeve celulare ndërkombëtare		
3	Terminimi i SMS-ve celular		
4	Të dhëna (data)		
5	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
Të ardhurat nga jashtë			
1	Tregu me pakicë - Telefonatat brenda grupeve të mbyllura		
	Tregu me pakicë - Telefonatat brenda rrjetit		
	Tregu me pakicë - Telefonatat kombëtare		
	Tregu me pakicë - Telefonatat roaming		
	Të tjera (zgjero sipas nevojës)		
2	Terminimi i thirrjeve celulare		
3	Terminimi i SMS-ve celular		
4			
5			
Totali i të ardhurave			
Kostot e operimit (si në A2.2)			
Fitimi (HCA)			
CCA e korrektuar (si në A2.2)			
Fitimi (CCA)			
Fitimi mbi kapitalin në përdorim			

Shënim: Shikoni A2.3 për vlerat e kapitalit mesatar të punësuar

A2.3 Kapitali mesatar në përdorim (i punësuar)

	Viti	Viti
	aktual	i mëparshëm
Aktive fikse		
Aktive fikse të trupëzuara (të prekshme)		
Aktive fikse të patrupëzuara		
Investimet		
Aktive fikse gjithsej		
Aktive afatshkurtra		
Gjendjet		
Debitorët		
Investimet		
Të hollat (cash)		
Totali i Aktiveve afatshkurtra		
Aktivitet gjithsej		
Kreditorët		
Provizionet për detyrimet dhe pagesat		
Kapitali mesatar në përdorim (i punësuar)		

Shënim: Llogaritja e fitimit mbi kapitalin mesatar në përdorim duhet të jetë konsistente me bazat mbi të cilat është llogaritur kostoja e kapitalit. Nëse është përdorur një WACC para-tatim dhe para-interes, atëherë fitimi i paraqitur duhet të jetë fitimi përpara interesit dhe tatimit.

Detajet e bilancit të paraqitur duhet të përgatiten me bazë kostot aktuale dhe duhet të jenë vlera mesatare për vitin me të cilin lidhen.

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

A2.4 Pasqyra e Transferimeve

		Telefonatat fikse	Telefonatat fikse	Lokal	Broadband	Dhënë me qira afatgjatë	Telefonata celulare	SMS celulare	Total
		Origjinimi	Terminimi	Akses	Akses	Linjat	Terminimi	Terminimi	Transferimet
Shërbimet e shitjes me pakicë									
	Pagesa mujore e linjës dhe lidhja								
	Telefonatat nga linjat fikse								
	Broadband								
	Linjat me qira								
	Ndërkombëtare								
	Thirrjet celulare								
	Mesazhet celulare								
	Shërbimet të tjera								

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

A2.5 Përmbledhje për Transferimet brenda Biznesit

tek	Aksesi me pakicë	Tregu me pakicë i linjave dhe telefonatave	Tregu me pakicë i linjave me qira	Shitje të tjera me pakicë	Aksesi me shumice	Thirrje me shumicë	Broadband me shumicë	Linja me qira me shumicë	Tregu me shumicë i Interkoneksionit	Të lëvizshëm (celular)	Tjetër
Nga											
Tregu me pakicë i aksesit											
Tregu me pakicë i linjave dhe telefonatave											
Tregu me pakicë i linjave me qira											
Shitje të tjera me pakicë											
Tregu me shumicë i aksesit											
Tregu me shumicë i thirrjeve											
Tregu me shumicë i broadband											
Tregu me shumicë i linjave me qira											
Tregu me shumicë i Interkoneksionit											
Të lëvizshëm (celulare)											
Tjetër											

A2.6 Pasqyra e Rakordimit - Fitimi dhe Humbjet (të ardhurat dhe shpenzimet)

	Të ardhurat	Kostot operacional	Fitimi
Veprimtaritë			
Tregjet me FNT të shitjes me shumicë			
Tregjet FNT të shitjes me pakicë			
Tregjet pa FNT të shitjes me shumicë			
Tregjet pa FNT të shitjes me pakicë			
Shërbime/Tregje të tjera			
Total			
Korrektimet			
Korrektimet e CCA			
Taksa e korporatës			
Dividendët			
Interesi			
Tjetër			
Total			
Siç është deklaruar në raportin vjetor			

A2.7 Kapitali i Mesatar i Konsoliduar

	Viti i tanishëm	Viti i mëparshëm
Fondet e aksionerëve për raport vjetor		
Korrektimi i CCA		
Korrektimi i interesit		
Korrektimi i Taksave		
Korrektimi i dividendëve		
Korrektime të tjera		
Totali i kapitalit mesatar në përdorim CCA		
Tregjet FNT të shitjes me shumicë		
Tregjet FNT të shitjes me pakicë		
Tregjet pa FNT të shitjes me shumicë		
Tregjet pa FNT të shitjes me pakicë		
Shërbime/Tregje të tjera		
Totali i kapitalit mesatar në përdorim CCA		

Shënim: Kjo pasqyrë duhet të rakordojë me A2.3

2.5 A2.8 Pasqyra e kostove të shërbimeve të rrjetit

Pasqyra e Kostove								
	Kostot operacionale	Kostot e jashtëzakonshme operacionale	Kapitali mesatar në përdorim	Norma e fitimit mbi kapitalin në përdorim	Kostot e kapitalit	Kostot operative të kapitalit	Vëllimi	Kostoja mesatare për njësi
FAC								
Rrjeti i aksesit								
Rrjeti me fibra								
Pajisjet e aksesit								
Pajisjet DSL								
Provizionet dhe riparimet								
<i>Ndryshojnë me numrin e linjave (line sensitive)</i>								
Njësia e pajtimtarit								
<i>Ndryshojnë me thirrjet telefonike (call sensitive)</i>								
Njësia e pajtimtarit								
Centrali lokal i lidhur direkt me pajtimtarin								
Centrali gateëay								
<i>Ndryshojnë me trafikun (traffic sensitive)</i>								
Njësia e pajtimtarit								
Centrali lokal i lidhur direkt me pajtimtarin								
Centrali gateëay								
Pajisja e interkoneksionit								
Rrjeti inteligjent								

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

Centrale të tjerë								
Rrjeti i transmetimit								
<i>Nuk varet nga gjatësia</i>								
RSU te centrali lokal								
Central lokal me central lokal								
Central lokal me central gateëay								
Linjë interkoneksioni								
Lidhja e të dhënave								
Lidhja DSL								
Lidhja NGN								
Lidhje tjetër								
<i>I varur nga gjatësia</i>								
Gjatësia RSU me central lokal								
Gjatësia cetral lokal me central lokal								
Gjatësia central lokal me gateëay								
Gjatësia e linjës së interkoneksionit								
Gjatësia e linjës së të dhënave								
Gjatësia e linjës DSL								
Gjatësia e linjës NGN								
Gjatësi tjetër								
Platformat e të dhënave								
Pagesa për të tretët (outpayments)								
Adminsitrimi dhe faturimi si bartës								
Elementë të tjerë të FNT								
Elementë jo FNT								
Total								

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

A2.9 Përmbledhje e kostove të rrjetit

FAC	Kostot totale operacionale dhe të kapitalit	Origjinimi i thirrjeve me shumicë fikse	Terminimi me shumicë i thirrjeve fikse	Akresi lokal me shumicë	Akresi broadband me shumicë	Llinjat me qira me shumicë	Interkoneksioni me shumicë	Terminimi i thirrjeve celularë	Pjesa e mbetur e shitjeve me shumicë të rregulluara	Pjesa e mbetur e shitjeve me shumicë të parregulluara	Tregu me pakicë
Rrjeti i aksesit											
Rrjeti me fibra											
Pajisjet e aksesit											
Pajisjet DSL											
Provizionet dhe riparimet											
<i>Ndryshojnë me numrin e linjave (line sensitive)</i>											
Njësia e pajtimtarit											
<i>Ndryshojnë me thirrjet telefonike (call sensitive)</i>											
Njësia e pajtimtarit											
Centrali lokal i lidhur direkt me pajtimtarin											
Centrali gateway											

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

<i>Ndryshojnë me trafikun (traffic sensitive)</i>											
Njësia e pajtimtarit											
Centrali lokal i lidhur direkt me pajtimtarin											
Centrali gateëay											
Pajisja e interkoneksionit											
Rrjeti inteligjent											
Centrale të tjerë											
Rrjeti i transmetimit											
<i>Nuk varet nga gjatësia</i>											
RSU te centrali lokal											
Central lokal me central lokal											
Central lokal me central gateway											
Linjë interkoneksioni											
Lidhja e të dhënave											
Lidhja DSL											
Lidhja NGN											
Lidhje tjetër											
<i>I varur nga gjatësia</i>											
Gjatësia RSU me central lokal											
Gjatësia cetral lokal me central lokal											

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

Gjatësia central lokal me gateway											
Gjatësia e linjës së interkoneksionit											
Gjatësia e linjës së të dhënave											
Gjatësia e linjës DSL											
Gjatësia e linjës NGN											
Gjatësi tjetër											
Platformat e të dhënave											
Pagesa për të tretët (outpayments)											
Administrimi dhe faturimi si bartës											
Elementë të tjerë të FNT											
Elementë jo FNT											
Kostot Totale të rrjetit											
Kosto të ndryshme të alokuara											
Kostot totale me shumicë											

Shënim; Këto pasqyra janë shembuj që sipërmarrësit me FNT mund të përdorin për të krijuar pasqyrat e tyre që të përmbushin detyrimet e përcaktuara në këto rregulla dhe udhëzime. Ato synojnë të jenë shembuj ilustrues dhe jo përfundimtarë. Sipërmarrësit me FNT duhet të

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

prodhojnë një pasqyrë që të demonstrojnë rrejetet dhe veprimtaritë e tyre. Këta shembuj janë mbështetur mbi praktikat më të mira ndërkombëtare të përshtatshme, të cilat mund të jenë një burim i dobishëm për sipërmarrësit ndërkohë që krijojnë pasqyrat e tyre.

A3 Informacion Shtesë

A3.1 Deklarata Shpjeguese

Çdo treg përkatës me FNT i raportuar në pasqyrat P&L⁹ nga Sipërmarrësit me FNT duhet të mbulohet nga një deklaratë e shkurtër shpjeguese, që i shërben qëllimit të një rishikimi të përgjithshëm biznesi dhe si një udhëzues i shpejtë për çdo ndryshim të madh. Deklarata duhet të përfshijë pjesët e mëposhtme:

- Përkufizimi i tregut
- Produktet kryesore të tregut
- Kuadri rregullator i vendosjes së çmimit
- Vendimet rregullatore gjatë periudhës
- Të ardhurat dhe tendencat e volumit
- Ngjarjet e jashtëzakonshme dhe ndryshimet e metodologjisë

A3.2 Informacion Financiar Shtesë

Dokumentacioni mbështetës është një element jetik në raportimin rregullator financiar pasi e lejon një sipërmarrës me FNT të shpjegojë dhe justifikojë rezultatet si dhe lejon një rregullator t'i kuptojë ato dhe të masë me saktësi pajtueshmërinë. Tabela më poshtë përcakton një numër fushash që duhen mbuluar me informacion shtesë, e cila nuk është përfundimtare por duhet të ofrojë një udhëzues të fortë se çfarë kërkohet për plotësimin e dokumentacionit të dorëzuar. Kur një sipërmarrës me FNT përgatit dokumentet përfundimtare, duhet të marrë parasysh këtë udhëzues dhe të diskutojë ofrimin e informacionit me AKEP-in si pjesë e angazhimit të dobishëm që të dyja palët kanë të drejtë të presin.

Informacion shtesë	Qëllimi
Numri i punonjësve për segment/departament/shërbim tregu	Analiza e kostos dhe e eficensës
Kostoja e punës për segment/departament/shërbim tregu	Analiza e kostos dhe e eficensës
Detaje të rezultateve nga kërkime të ndryshme (madhësia e kampinit, madhësia e popullatës, vëzhgimet statistikore, metodologjia, etj.)	Kuptimi i pasqyrave
Analiza e kostove të jashtëzakonshme	Kuptimi i pasqyrave dhe i modelimit
Kategoritë e kostos së modelimit LRIC për komponentët e rrjetit, inkrementet dhe kostot e përbashkëta	Kuptimi i modelimit

⁹ Pasqyra e Tw Ardhurave dhe Shpenzimeve (Shwnim i prkthyesit)

Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostove për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme (FNT) në Shqipëri

Analiza e veprimtarisë për elementët e rrjetit, inkrementet dhe kostot e përbashkëta	Kuptimi i modelimit
Analiza e faktorëve të rrugëzimit dhe përdorimit për rrjetet dhe pajisjet	Kuptimi i modelimit
Grafikë që përfaqësojnë kurbat e kostove dhe CVR-t	Kuptimi i modelimit
Analizat e amortizimit dhe vlerësimi CCA sipas kategorive të aktiveve dhe veprimtarive të rrjetit	Kuptimi i pasqyrave dhe veprimeve që kanë të bëjnë me aktivet
Analiza e kapitalit të punësuar për rrjetin dhe elementët e rrjetit	Kuptimi i pasqyrave
Analizat e të ardhura që detajojnë tariaft e thirrjeve, uljet (skontot), llojet e pagesave, paketat dhe tarifatat, opsionet e përdoruesit, etj.	Kuptimi i pasqyrave të të ardhurave dhe analiza e ngushtimit të marzheve (margin squeeze)
Analiza e shpenzimeve për marketingun që ka lidhje me fushatat dhe promocionet	Kuptimi i kostove të marketingut

Shënim: Ky lloj i raportimit shtesë do të jetë konfidencial ndërmjet AKEP-it dhe sipërmarrësit me FNT dhe nuk do të përbëjë një pjesë të raportimit të disponueshëm për publikun.

A4 Opinioni i Auditimit

Më poshtë është dhënë një format opinionit i sugjeruar për auditin që tregon llojin e deklaratave që priten të nxirren nga një audit mbi përfundimin e auditimit të rezultateve të ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos.

"Ne kemi audituar dokumentacionin rregullator financiar bashkëngjitur të firmës XXX, që përbëhen nga pasqyra financiare rregullatore (të ardhura dhe shpenzime, kapitali mesatar i punësuar, rakordimet, raportet e kostove për njësi, deklarata e përgjegjësisë nga Bordi, raporti i pagesave të transferimeve) dokumentet e kontabilitetit (parimet, përcaktimet, politikat, metodat e vlerësimit, përshkrimet e modelit të kostos, etj) dhe përshkrimin e dokumentuar të alokimit të kostove.

Përgjegjësia e menaxhimit për pasqyrat financiare rregullatore

Administrimi (menaxhimi) i kompanisë (administratori i kompanisë) është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen objektive të pasqyrave financiare në formatin e duhur në përputhje me detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos të vendosur nga AKEP. Përgjegjësitë e menaxhimit të kompanisë përfshijnë përcaktimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme të kërkuara për të mundur përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare rregullatore që nuk përmbajnë gabime ose mashtrime të konsiderueshme. Menaxhimi duhet të zgjedhë dhe të zbatojë politikat e duhura të kontabilitetit dhe të përcaktojë metodologjitë për modelimin dhe vlerësimin e duhur sipas rrethanave.

Përgjegjësia e auditit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare rregullatore mbështetur në kontrollin tonë. Auditimi është kryer në përputhje me detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos të vendosura nga AKEP, i cili kërkon që auditit të përcaktojë se pasqyrat financiare rregullatore japin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë të biznesit të XXX-së dhe nuk përmbajnë gabime të konsiderueshme.

Auditimi përfshin procedura për të grumbulluar prova të kontrollit që kanë të bëjnë me shumatat dhe pasqyrat në dokumentet financiare rregullatore të dorëzuara. Ne kemi ekzaminuar rakordinin e të dhënave të modelit të kostos me pasqyrat financiare rregullatore dhe këto pasqyra me pasqyrat financiare ligjore. Ne kemi ekzaminuar modelimin e kostos për saktësi dhe pajtueshmëri me dispozitat e rregullave dhe udhëzimeve të AKEP. Ne kemi ekzaminuar pajtueshmërinë e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos të kryer nga XXX me dispozitat ligjore të vendimeve të AKEP.

Ne kemi arritur në përfundimin se prova e auditimit është e mjaftueshme për të krijuar një opinion të shëndoshë të auditit.

Opinionit

Për mendimin tonë, pasqyrat financiare rregullatore të prodhuara dhe paraqitura nga XXX japin një përfaqësim të vërtetë e të plotë të biznesit dhe veprimtarive të XXX në lidhje me detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos të vendosura nga AKEP.

Gjatë këtij auditimi nuk janë gjetur shenja që XXX nuk zbaton detyrimet e ndarjes së llogarive dhe llogaritjen e kostos të vendosur nga AKEP.

Shënim: Teksti i ofruar më sipër është thjesht përshkrues dhe nuk synon të kufizojë aftësinë e pavarur të audituesve të caktuar për të kryer detyrën e tyre dhe të japin një opinion mbi pajtueshmërinë rregullatore të Sipërmarrësve individualë me FNT në Shqipëri.

Shtojca 3 Fjalor i Termave

Kostot Bazuar në Aktivitete (ABC)

Një metodologji që identifikon shërbimet dhe produktet si pasojë e aktiviteteve, ku secili aktivitet përdor burimet e organizatës, duke gjeneruar në këtë mënyrë kosto. Kjo metodologji, bazuar në shtytësit e kostove, gjurmon dhe alokon kostot në bazë të aktiviteteve të realizuara dhe vendos lidhje të qarta shkakësore ndërmjet aktiviteteve, kostove dhe shërbime shoqëruese që burojnë prej tyre.

Vlera kontabël

Shuma e regjistruar në regjistrat e kontabilitetit të Sipërmarrësit në lidhje me aktivitet fikse, duke përfshirë normalisht shpenzimet e blerjeve dhe komisioneve plus, nëse është e përshtatshme, kostot e brendshme të shkaktuara, të tilla si kostot e punës së instalimit, për sjelljen në përdorim të aktivitetit. Vlera neto kontabël përfaqëson vlerën bruto të çdo aktivi, minus amortizimin, zhvlerësimin apo pakësimin e vlerës së regjistruar gjatë jetës ekonomike të aktivitetit.

Bottom up LRIC

Një lloj modeli LRIC (Long Run Incremental Cost) i krijuar duke përdorur një model inxhinierik dhe të topologjisë së rrjetit për të përfaqësuar një rrjet eficient të arsyeshëm, duke përdorur të vëllime të parashikuara të klientëve dhe trafikut. Modeli më i përdorur për përcaktimin e tarifave nën-rrregullim të orientuara në kosto.

Modeli i Vlerësimit të Aktiveve Kapitale (CAPM)

Një metodë për përcaktimin e çmimit të kapitalit aksionar duke e lidhur vlerën e kapitalit me rrezikun shoqëruar që investitorët duhet të marrin përsipër dhe duke supozuar që një aktiv është duke u shtuar në një portofol tashmë të diversifikuar. Rreziku klasifikohet si rreziku i tregut (që llogaritet duke përdorur një faktor beta) dhe normat teorike të fitimit pa rrezik.

Kosto të Përbashkëta

Kostot që nuk mund të alokohen direkt te elementët e rrjetit dhe të cilat janë të përbashkëta për një ose më shumë aktivitete. Për këtë arsye, kosto të tilla mundet të eliminohen vetëm duke ndaluar të gjitha aktivitetet për të cilat kostot janë të përbashkëta.

Orientim në kosto:

Parimi se çmimi i tarifuar për ofrimin e një shërbimi duhet të pasqyrojnë kostot e shkaktuara nga ofrimi i atij shërbimi.

Metodologjia e kostove

Përshkruan rendin dhe mënyrën në të cilën procedurat dhe metodat aplikohen për të nxjerrë dhe atribuar kostot për shërbimet.

Kontabiliteti me Kosto Aktuale (CCA)

Një bazë kontabël që njih dhe përfshin efektet e ndryshimit të çmimeve, sidomos të aktiveve kapitale, me kalimin e kohës.

Metoda e Marzhit Proporcional Ekuivalent (EPMU)

Një metodë me të cilën shpenzimet e përbashkëta alokohen për shërbimet apo produktet në proporcion me kostot inkrementale të cilat tashmë janë alokuar për këto shërbime apo produkte. Kjo do të thotë se për çdo shërbim është llogaritur një pjesë në përqindje në shpenzimet totale inkrementale, dhe shpenzimet e përbashkëta alokohen për këtë shërbim në proporcion me këto përqindje.

Kostot direkte

Kostoja që mund të gjurmohen direkt në një shërbim apo produkt dhe për këtë arsye nuk kërkojnë analizë të mëtejshme në një sistem kostosh.

Ruajtja e kapitalit financiar

Një koncept i cili merr parasysh ruajtjen e kapitalit financiar të një kompanie dhe aftësisw sw saj për të vazhduar financimin e aktiviteteve të saj. Sipas kësaj metode, vlera e kapitalit ruhet kur vlera reale e kapitalit aksioner në fund të periudhës kontabël është në të njëjtin nivel si në fillim të periudhës. Në përputhje me këtë koncept, fitim realizohet vetëm kur ka rezerva të mjaftueshme për të mbajtur një nivel të barabartë të fuqisë blerëse të kapitalit fillestar financiar.

Kostot e plotësisht të alokuara (FAC)

Përkrahuan një metodologji kostosh me të cilën të gjitha shpenzimet përkatëse i atribuohen prodhimeve të pwraktuara të tilla si produktet dhe shërbimet. Parimi i shkakësisë së kostos shpesh zbatohet për të mbështetur këtë metodologji .

Kosto Bruto e Zëvendësimit (GRC)

Vlera e aktiveve të reja, ose një pjesë e rrjetit të telekomunikacionit të cilat mund të ofrojnë të njëjtin nivel të funksionalitetit dhe kapacitetit si aktivet ekzistuese, ose një pjesë të rrjetit të telekomunikacionit, duke marrë parasysh ndryshimet në teknologji dhe në kohën e blerjes së pajisjeve.

Kontabiliteti me Kosto Historike (HCA)

Një bazë e kontabilitetit ku veprimet regjistrohen dhe raportohen me vlerën e tyre fillestare të transaksionit. Është përdorur tradicionalisht si bazë kryesore e raportimit për qëllime ligjore dhe të menaxhimit .

Fitimet dhe humbjet e mbajtura

Rregullimi i nevojshëm për të reflektuar rritjen ose zvogëlimin e vlerave të aktiveve që rrjedhin nga ndryshimet reale tw çmimeve apo rregullimeve të përfshira në CCA.

Kostot indirekte

Kostot që nuk mund të gjurmohen drejtpërdrejt te produkte apo shërbime të veçanta dhe për këtë arsye duhet t'u nënshtrohen niveleve të mëtejshme të alokimit ose shpërndarjas brenda një sistemi të kostove.

Indeksimi

Një metodë me të cilën vlera e aktiveve në vitet e ardhshme vlerësohet duke përdorur një indeks vjetor të çmimeve .

Kostot e bashkuara (joint costs)

Kostot të cilat ndodhin gjatë prodhimit të një ose më shumë produkteve në proporcione fikse pavarësisht nga vëllimi dhe për këtë arsye janë të nevojshme për t'u ndarë midis produkteve në një sistem kostosh.

Long Run Incremental Cost (LRIC)

Kostoja e prodhimit të një inkrementi shtese të specifikuar (zakonisht një aktivitet, shërbim ose produkt) në periudhë afat-gjatë (periudha gjatë së cilës të gjitha kostot janë të ndryshueshme) duke supozuar që prodhohet të paktën një inkrement tjetër.

Aktiv Modern Ekuivalent (MEA)

Aktive me karakteristika dhe parametrate teknike të ngjashme, si dhe kapacitete dhe potenciale prodhues të ngjashëm ose më të mëdha sesa aktivet që Aktivi Modern Ekuivalent do të zëvendësojë.

Kostoja neto zëvendësimit

Kostoja e zëvendësimit të një aktivi ekzistues me një aktiv tjetër me jetëgjatësi dhe karakteristika të ngjashme.

Ruajtja e kapitalit e operacional

Alternativa e ruajtjes së kapitalit financiar, ku ruhet kapaciteti operacional prodhues i biznesit, në ndryshim nga vlera financiare.

LRIC i pastër

Një version i koston rritëse që nuk lejon për mbulimin e asnjë Kostoje të Përbashkët dhe mat rritjen si vetëm atë që shmanget duke mos e prodhuar njësinë përkatëse.

Oferta Reference e Interkoneksionit (RIO)

Një dokument, i miratuar nga Autoriteti Rregullator Kombëtar, dhe publikuar nga një **Sipërmarrës** me FNT, që përmbledh masat teknike dhe komerciale sipas të cilave ai do të ofrojë shërbimet e tij me shumicë për të gjithë **Sipërmarrësit** e tjerë të licencuar në treg.

Fuqia e Ndjeshme në Treg (FNT)

Një pozicion në një treg, i përcaktuar nga një Autoritet Rregullator Kombëtar pas procesit të analizës të tregut, ku një Sipërmarrës konsiderohet të ketë një ndikim dominant në një treg.

Qasja ' nyje djegur '

Një metodë e përdorur në modelimin e kostove që lejon për një topologji rrjetitë bazuar në topologjinë dhe strukturën ekzistuese, në ndryshim nga një metodë optimizimi dhe zëvendësimi.

Kostot e vetme të pavaruara (Stand Alone Cost)

Shpenzimet e bëra në ofrimin e një inkrementi kur nuk prodhohen rritje të tjera, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e përbashkëta dhe në përgjithësi duke rezultuar në vlerën më të lartë të kostos për një rritje.

Model Lart-poshtë LRIC

Një model kosto që merr si pikë fillestare kostot reale të Sipërmarrësit të marra nga sistemet e kontabilitetit, si dhe topologjinë dhe arkitekturën e ekzistuese të rrjetit të telekomunikacionit, duke përdorur të dhënat e parashikimit dhe një qasje në perspektive për eficensën për të nxjerrë kostot për njësi.

Pagesat për transferimet

Sistemi i tarifimit të brendshëm ndërmjet njësive ose departamenteve të një kompanie vertikalisht të integruar.

Koston Mesatare e Ponderuar e Kapitalit (WACC)

Një masë e kthimit mesatar financiar të realizuar nga një biznes për kapitalin e investitorëve, e llogaritur në bazë të raportit midis borxhit dhe kapitalit të pronarëve të zbatueshme për kompaninë.